

Ky manual ofron udhëzime mbi monitorimin e pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor. Ajo ka qenë zhvilluar si pjesë e përpjekjeve të OSBE/ODIHR-it për të përmirësuar barazinë midis grave dhe burrave duke theksuar qartë çështjet gjinore në të gjitha sferat e punës së tij.

Ky manual është hartuar si një mjet pune për tu ndihmuar MVZ të OSBE/ODIHR-it në identifikimin e elementeve të ndryshme që mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e barabartë e grave. Ai përcakton hapat praktike që duhet të ndërmerren për integrimin e perspektivës gjinore në vëzhgimin e zgjedhjeve dhe duhet të shërbejë për të siguruar që konkluzionet e nxjerra në shkallën në të cilën një proces zgjedhor i plotëson përbetimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike merr plotësisht parasysh si ndikon në procesin zgjedhor edhe mbi gratë edhe mbi burrat.

Si shtesë të përdorimit nga Misionet Vëzhguese për Zgjedhjet të OSBE/ODIHR-it, manualu gjithashtu ka rëndësi të gjerë për përpjekjet e vëzhguesve të tjerë ndërkombëtar të zgjedhjeve dhe për punën e grupeve të vëzhguese vendor të zgjedhjeve.



MANUAL PËR MONITORIMIN E PJESËMARRJES SË GRUAS NË ZGJEDHJE

MANUAL
PËR MONITORIMIN E
PJESËMARRJES SË GRUAS
NË ZGJEDHJE

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtjet e këtij botimi mund të përdoren dhe kopjohen lirisht për qëllime arsimore dhe qëllime të tjera jokomerciale, me kusht që gjatë çdo riprodhimi ti jepet mirënjohje OSBE/ODIHR-it si burimi i tyre.

Ky publikim është një përkthim i titullit të ODIHR-it “Manual për Monitorimin e Pjesëmarrjes së Gruas në Zgjedhje,” OSCE/ODIHR 2004 përpunuar nga Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup.

Fotografitë u mundësuan nga Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup.

Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup
Ndërtesa QBE, Shkup
11 Oktomvri 25

osce.org/skopje

MANUAL

PËR MONITORIMIN E
PJESËMARRJES SË GRUAS
NË ZGJEDHJE



PERMBAJTJA

HYRJE 7

A. Qëllimi i këtij manuali	7
B. Si të përdoret ky manual.....	7
1. HISTORIA E MONITORIMIT TË GJINISË DHE ZGJEDHJEVE: INFORMATAT PËR TË GJITHË ANËTARËT E MISIONIT VËZHgues TË ZGJEDHJEVE.....	9
A. Shqyrtim i rolit të një Misioni vëzhgues të zgjedhjeve në vëzhgimin e pjesëmarrjes së gruas	9
B. Standardet ndërkombëtare.....	10
C. Statusi aktual i gruas në udhëheqjen globale.....	11
D. Detyrat specifike të misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve	11
2. KONTEKSTI LIGJOR: ROLI I ANALISTIT LIGJOR.....	15
A. Hulumtim i përgjithshëm i kornizës ligjore	15
B. Garancitë kushtetuese të të drejtave të grave	16
C. Ligjet e tjera që ndikojnë në barazinë dhe pjesëmarrjen politike të gruas.....	16
D. Pengesat potenciale të mbrojtjes ligjore të të drejtave të grave	17
3. SISTEMI ZGJEDHOR DHE ADMINISTRATA ZGJEDHORE: ROLI I ANALISTIT ZGJEDHOR	21
A. Sistemet zgjedhore	21
1. Sistemet e përfaqësimit proporcional	22
2. Sistemet e shumicës/ pluralizmit	22
B. Elementet e proceseve zgjedhore të cilat ndikojnë pjesëmarrjen e grave	23
C. Kuotat dhe veprimet afirmative	24
D. Pjesëmarrje në administratën zgjedhore	25
E. Regjistrimi i votuesve	25

4. PARTITË POLITIKE DHE AVANCIMI I GRAVE: ROLI I ANALISTIT POLITIK..31	
A. Organizimi i brendshëm dhe implikimet për gratë	31
B. Faktorët që mund të dëmtojnë qëllimet e mira	32
C. Platformat dhe përpjekjet për fitimin e votave të grave	33
5. GRATË DHE MEDIUMET: ROLI I ANALISTIT TË MEDIUMEVE	35
A. Mediumet dhe ndikimi i tyre në qëndrimet publike	35
B. Çështjet e përgjithshme për tu ndjekur	36
C. Teknikat për monitorimin e mediumeve gjatë fushatave zgjedhore	36
6. VAGJ DHE VASH: ROLI I KOORDINATORIT TË VAGJ	39
A. Vëzhguesit afatgjatë (VAGJ).....	39
B. Vëzhguesit afatshkurtër (VASH).....	40
7. ANALIZA ME MË SHUMË DETAJE DHE INFORMATA: ROLI I ANALISTIT GJINOR	43
A. Gratë në shoqëri	43
B. Gratë në politikë.....	44
C. Burimet zyrtare të informimit	46
D. Organizatat joqeveritare.....	47
SHTOJCA: STANDARDET E ZGJEDHURA NDËRKOMBËTARE	49
RRETH OSBE/ODIHR-it	52

HYRJE

A. Qëllimi i këtij manuali

Të gjitha shtetet pjesëtare të OSBE-së e njohin barazinë midis grave dhe burrave si aspekt fundamental i një shoqërie të drejtë dhe demokratike. Ata janë të angazhuar për të nxitur mundësi të barabarta për pjesëmarrje të plotë të grave në të gjitha aspektet e jetës politike dhe publike. Ky manual ofron udhëzime themelore për të gjithë Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) të OSBE/ODIHR-it për monitorimin e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore. Kjo është zhvilluar si pjesë e përpjekjeve të ODIHR-it për të përmirësuar barazinë midis grave dhe burrave me integrimin e çështjeve gjinore në të gjitha sferat e veprimit të saj. Manuali parashtron hapat praktike të cilat duhet të ndërmerren nga çdo MVZ për integrimin e perspektivës gjinore në veprimin e tij, duke plotësuar informatat në *Manualun e Vëzhgimit të Zgjedhjeve* të ODIHR-it dhe materialevë tjera të përgatitura nga ODIHR-i.

Udhëzimet e dhëna në këtë manual kanë për qëllim të sigurojnë që secili Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nxjerr konkluzionet mbi shkallën në të cilën një proces zgjedhor i përbush zotimet e OSBE-së dhe reflekton parimet universale, merr plotësisht parasysh se si ndikon në procesin zgjedhor edhe te gratë edhe te burrat. Një zgjedhje nuk mund të përbushë

zotimet e OSBE-së apo të përbushë standardet e tjera ndërkombëtare, nëse nuk përfshin mundësinë për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të grave.

Arritje e konkluzioneve të sakta për këto çështje kërkon ndërgjegjësimin dhe kontributin e të gjithë anëtarëve të MVZ. Monitorimi i pjesëmarrjes të barabartë të grave në procesin zgjedhor është një përgjegjësi e përbashkët për çdo anëtar të Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, duke përfshirë ekipin kryesor dhe vëzhguesit afatgjatë dhe afatshkurtër.

B. Si të përdoret ky manual

Ky manual është hartuar si një mjet pune. Ai duhet t'ju ndihmojë të gjitha MVZ në identifikimin dhe vlerësimin e elementeve të ndryshme që mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e barabartë të grave në politike. Manuali ka qenë strukturuar t'ju mundësojë anëtarëve të MVZ të përqendrohen shpejt në materialet më të rëndësishme për përgjegjësitë e tyre specifike.

- ▶ Kapitulli nismëtar jep një pasqyrë të përgjithshme dhe prapavijë thelbësore për gjininë dhe zgjedhjet që duhet të jetë e vlefshme për secilin anëtar të MVZ;

-
- ▶ Kapitujt në vijim mundësojnë informata bazë mbi aspektet gjinore të komponentëve të veçantë të procesit zgjedhor, të organizuar rreth strukturës normale të një Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të ODIHR-it. Kështu, ekziston një kapitull mbi çështjet ligjore projektuar për analistët ligjor të MVZ, një kapitull mbi sistemet zgjedhore për analistin e zgjedhjeve të MVZ, një kapitull mbi partitë politike për analistin politik të MVZ, dhe një kapitull mbi gratë dhe mediumet për analistin e medimeve të MVZ, si dhe një kapitull që siguron udhëzime për koordinatorin e vëzhguesve afatgjatë;
 - ▶ Për një MVZ me një analist gjinor me orar të plotë ose një asistent për pikë fokale gjinore, kapitulli përfundimtar mundëson udhëzime për informatat shtesë që do të jenë të dobishme të ndiqet më në thellësi atëherë kur do të jetë e mundshme;
 - ▶ Një shtojcë mundëson tekstet e zotimeve kryesore të OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare të rëndësishme për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje;
 - ▶ Një numër i listave kontrolluese janë përfshirë për të ndihmuar anëtarët e ekipit të kenë një fillim të shpejtë në ndjekjen e pikave të hetimit në lidhje me vëzhgimin e MVZ-së për pjesëmarrjen e grave, dhe për të siguruar një kujtesë të shpejtë të çështjeve që secili anëtar i grupit duhet të përpiqet ti trajtojë. Nuk pritet që secila çështje të mbulohej nga secila MVZ.
- Pasi që secili mjedis i zgjedhjeve është unik, të gjitha çështjet e hulumtuara në këtë manual ndoshta nuk do të jenë relevante për çdo zgjedhje të vëzhguar. Në mënyrë të njëjtë, MVZ të ndryshme do të jenë në gjendje ti kushtojnë më shumë ose më pak theks çështjeve gjinore në varësi nga madhësia e tyre, gjatësia, dhe burimet. Në kuadër të burimeve të saj, megjithatë, secili MVZ merr parasysh çështjet gjinore dhe përfshin ata në metodologjinë e tij, raportimin e tij, dhe, sipas mundësisë në rekomandimet e tij.

1.



HISTORIA E MONITORIMIT TË GJINISË DHE ZGJEDHJEVE:

Informatat për të gjithë anëtarët e misionit vëzhgues të zgjedhjeve

A. Shqyrtim i rolit të një Misioni vëzhgues të zgjedhjeve në vëzhgimin e pjesëmarrjes së gra

Çështjet gjinore prekin të gjitha aspektet e zgjedhjeve dhe për këtë arsye janë pjesë integrale e punës së një Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Të gjithë anëtarët e MVZ duhet të jenë të vetëdijshëm se si çështjet gjinore kanë të bëjnë me sferat e tyre specifike të përgjegjësisë brenda MVZ. Në kryerjen e detyrave të tyre, ata duhet të konsiderojnë si strukturat juridike, politike, dhe sociale ndikojnë mbi gratë, si edhe mbi burrat në procesin zgjedhor. Për shembull, puna e MVZ do të përfshijë hulumtimin e pjesëmarrjes të grave si votues, kandidatë dhe përfaqësues të zgjedhur; pjesëmarrjen e grave në rolet e lidershit brenda institucioneve shtetërore, komisioneve zgjedhore, dhe partive të politike; dhe si korniza ligjore dhe strukturat e medimeve ndikojë mbi gratë si edhe

mbi burrat. Të gjithë anëtarët e MVZ duhet të ndjekin informatat në lidhje me pjesëmarrjen e grave pasi që ata kryejnë aktivitete që lidhen me detyrat e tyre normalisht të caktuara, dhe ata duhet të nxjerrin konkluzionet e duhura për atë se si strukturat dhe praktikat kombëtare ndikojnë në pjesëmarrjen politike të grave.

Si elemente të tjera të një Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, monitorimi gjinor ka për qëllim të mbledhë informata, të vlerësojë shkallën në të cilën ligji dhe praktika përmbushin zotimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare, dhe pastaj të bëjë rekomandime konstruktive për vendin nikoqir. Secili takim me ndonjë funksionar, parti politike, përfaqësues të medimeve, apo të OJQ-ve ofron mundësi për të fituar njohuri në lidhje me të drejtat e grave, ndonjë pengesë për pjesëmarrjen e tyre të barabartë në jetën publike, dhe reformat që mund të ndihmojnë për të tejkaluar diskriminimin aty ku ai ekziston.

Kreu i secilit Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve do të drejtojë punën e tij në përbushjen e qëllimeve të monitorimit gjinor të ODIHR-it. Sa shpesh të jetë e mundur, analist gjinorë do të emërtohet në Mision. Kur kjo nuk është e mundur, ndonjë anëtar tjetër i ekipit kryesor duhet të caktohet si person përgjegjës për çështje gjinore për të bashkërenduar punën e Misionit për çështjet gjinore. Analisti gjinor ose personi përgjegjës duhet të jenë të përgatitur të informojnë shkurtimisht anëtarët e ekipit dhe të ofrojnë udhëzime shtesë mbi rrethanat që mund të kërkojnë vëmendje të veçantë.

B. Standardet ndërkombëtare

Në kuadër të OSBE-së, Dokumenti i Kopenhagës¹ përmban shumicën e zotimeve në veçanti në lidhje me zgjedhjet. Megjithatë, shumë zotime të tjera të OSBE-së janë gjithashtu kritike për realizimin e zgjedhjeve demokratike, duke përfshirë edhe zotimet për mosdiskriminim, të drejtat politike dhe sundimin e ligjit. Dispozitat e mosdiskriminimit mund të jenë veçanërisht të rëndësishme për të drejtat gjinore dhe të drejtat e grave. Paragrafi 5.9 i Dokumentit të Kopenhagës fton Shtetet pjesëmarrëse të "ndalojë rreptësisht çdo diskriminim dhe t'ju garantojnë të gjithë personave mbrojtje të barabartë dhe efektive kundër diskriminimit në çdo bazë."

Standardet kryesore të OSBE-së për barazinë gjinore janë të përfshira në Dokumentin e Moskës² dhe në Kartën Evropiane për Siguri,³ të dyja këto që obligojnë Shtetet pjesëmarrëse të promovojnë barazinë midis grave dhe burrave. Paragrafi 23 i Kartës Evropiane për Siguri, për shembull, thekson se, "Zbatimi i plotë dhe i barabartë nga gratë i të drejtave të tyre njerëzore është thelbësor për të arritur një zonë më të qetë, të begatshme dhe demokratike të OSBE-së. Ne jemi angazhuar ta bëjmë barazinë midis burrave dhe grave si një pjesë integrale të politikave tona, si në nivelin e shteteve tona ashtu edhe në kuadër të Organizatës".

Përveç kësaj, pothuajse të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së i kanë ratifikuar traktatet ndërkombëtare ose dokumentet e tjera të nxitjes së barazisë midis burrave dhe grave, duke përfshirë në mënyrë të veçantë Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) dhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR).

Një shtojcë në këtë manual siguron tekstet e disa standardeve kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe të drejtat njerëzore të grave që janë veçanërisht të rëndësishme për proceset zgjedhore.

¹ Dokumenti i Kopenhagës Takimin i Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE, 1990. Teksti i këtij dhe dokumenteve të tjera të OSBE-së mund të gjenden në faqen e internetit të OSBE-ja: www.osce.org

² Dokumenti i Mbledhjes së Konferencës së Moskës mbi Dimensionin Njerëzor, 1991.

³ Karta Evropiane e Sigurimit, Stamboll, 1999.

C. Statusi aktual i gruas në udhëheqjen globale

Avancimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave në jetën publike është edhe më tutje punë në vazhdim, edhe rreth rruzullit tokësor edhe në shtetet e OSBE-së. Në kuadër të OSBE-së, përqindja mesatare e përfaqësimit të grave në parlamentet është vetëm rreth 15 përqind, një shifër vetëm pak më e lartë se mesatarja botërore prej rreth 13 përqind.

Për të vënë këtë shifër në një tjetër këndvështrim, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka vlerësuar se “masë kritike” e cila ju mundëson grave si grup të ushtrojnë ndikim kuptimplotë në organet legjislative është 30 përqind. Vetëm në një pjesë të vogël të vendeve ky nivel është arritur.

Numri i ulët i grave në pozicione udhëheqëse shtrihet gjithashtu edhe në degën ekzekutive, ku përqindjet e grave kryesuese të qeverive dhe grave anëtarë të kabinetit janë edhe më të ulëta sesa nivelet e tyre në parlament. Për shembull, vetëm rreth 7 përqind të ministrave të kabineteve në botë janë gra.

D. Detyrat specifike të misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve

Në mënyrë që të analizojë në mënyrë efektive statusin e grave në politikë dhe në procesin zgjedhor, secila MVZ duhet të grumbullojë dhe vlerësojë të paktën një sasi minimale të informatave statistikore dhe informatave të tjera.

Misionet me analist gjinor me orar të plotë duhet të jenë në gjendje të marrin dhe analizojnë informatat në thellësi shumë më të madhe (shih Kapitullin 7). Të dhënat statistikore të mbledhura duhet të sigurojnë profil të mjedisit në të cilat zgjedhjet janë duke u zhvilluar dhe mund të përdoren gjithashtu si një bazë për krahasim për përcaktimin e trendeve pozitive apo negative lidhur me avancimin e grave brenda vendit që është duke u vëzhguar.

Të dhënat mund të përdoren gjithashtu për të ndihmuar në përcaktimin se çfarë lloj masash mund të miratohen nga qeveritë dhe partitë politike për të rritur përfaqësimin e grave. Përfundimisht, të dhënat mund të ndihmojnë gjithashtu të tregojnë se çfarë lloj të programeve të asistencës teknike ODIHR-i ose të tjerët mund të konsiderojnë të implementojnë e për të nxitur pjesëmarrjen e grave.

Së paku, MVZ duhet të përpiqet të fitojë dhe të raportojë të dhëna themelore statistikore të tilla siç janë:

- ▶ Numrat përkatës të burrave dhe grave të anëtarëve të parlamentit të posa zgjedhur dhe të atij që i përfundn mandati (ose organeve të tjera për të cilat janë duke u vëzhguar zgjedhjet) dhe, sa është e mundur, nga parlamentet e para-prake gjithashtu. Këto shifra do të ndihmojnë në krijimin e tendencave për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave;
- ▶ Numrin dhe përqindjen e grave që shërbejnë si ministra në qeveri në qeveritë e reja dhe atë që largohet. Nëse femrat mbajnë pozicione

shumë të lartë qeveritare jashtë qeverisë, për shembull, gjykatëse në gjykatat e larta, kjo është e vlefshme të merret në konsiderim;

- ▶ Numri i grave që shërbejnë si udhëheqës të partisë;
- ▶ Raporti i burrave dhe grave mes kandidatëve. Në zgjedhjet në përdorimin e listave partiake, statistikë e rëndësishme është numri i grave të vendosura në poste "fituese";
- ▶ Shkalla në të cilën gratë mbajnë poste në organe përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve, zakonisht në komisionin qendror zgjedhor, dhe në nivele më të ulëta të administratës zgjedhore;
- ▶ Numrat dhe raportet në të cilat gratë dhe burrat janë të regjistruar për të votuar. Statistikat janë zakonisht në dispozicion përmes një shumëllojshmëri burimesh, duke përfshirë ministrinë qeveritare, zyrat statistikore, komisionet zgjedhore, zyrat e vetëqeverisjes lokale, partive politike dhe OJQ-ve.

Përtej të dhënave statistikore, gjatë Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, anëtarët e ekipit duhet të fitojnë edhe lloje të tjera të informatave në lidhje me vendin e gruas në shoqëri dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin politik. Bazuar në takimet me kandidatët, partitë politike, zyrtarët e qeverisë, aktivistët civil, gazetarët, akademikët, gjykatësit dhe të tjerët, ekipi mund të

formulojë përshtypjet rreth qëndrimeve shoqërore ndaj grave dhe pranimin e tyre si drejtues dhe vendimmarrës. MVZ duhet të kërkojë t'ju përgjigjet pyetjeve vijuese:

- ▶ A kanë gratë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në procesin politik? Nëse jo, çfarë pengesa qëndrojnë në rrugën e tyre? Në veçanti, a thua ekzistojnë pengesa ligjore për pjesëmarrjen e barabartë të grave si votues, kandidatë, apo udhëheqës të zgjedhur?
- ▶ Nëse mundësitë janë të barabarta, a thua gratë përfitojnë prej tyre, dhe në qoftë se jo, pse? Për shembull, a është shkalla e analfabetizmit, papunësisë, varfërisë më e lartë midis grave? A ka pengesa të tjera politike ose shoqërore për pjesëmarrjen e grave?
- ▶ A ka ndonjë grup të veçantë të pakicave rajonale, etnike, ose fetare midis të cilave pjesëmarrja e grave është dukshëm më e ulët se në mesin e popullsisë së përgjithshme?
- ▶ A thua mundet të bëhet ndonjë ndryshim në ligj ose praktikë që do të rezultojë në pjesëmarrje më të madhe ose më shumë të barabartë nga femrat? Nëse po, cilat janë ato?
- ▶ Informatat e fituara nga pyetjet e tilla duhet të përfshihen si pjesë e raportit përfundimtar të MVZ-së.

LISTA KONTROLLUESE E INFORMATAVE THEMELORE KUANTITATIVE

PËRFAQËSIMI I GRAVE

- Si është ndarje gjinore e parlamenteve në largim dhe atyre të mëparshëm (këshillave komunale)?
- Sa femra janë ministra në qeveri (kryetare të komunave)?
- Cilat janë numrat dhe përmasat e burrave dhe grave që shërbejnë në organet qendrore dhe rajonale zgjedhore?

KANDIDATËT

- Për secilën parti, cila është ndarja gjinore e kandidatëve të tyre?
- Nga gratë në secilën listë të kandidatëve të partisë, sa janë në vende fituese?
- Sa gra janë duke konkuruar si kandidatë të pavarur?

VOTUESIT

- Sa votues prej secilës gjini janë të regjistruar?
- A ka pabarazi në disa rajone, për shembull, në zonat me përqëndrime të larta të pakicave, ose në zonat e prekura nga konflikti?

REZULTATET

- Sa gra janë zgjedhur? Çfarë përqindje të organeve të zgjedhura përfaqësojnë ata?
- A do të ketë më shumë ose më pak gra se sa në parlamentin në largim? A ka tendencë drejt zgjedhjes të më shumë ose më pak grave?

2.



KONTEKSTI LIGJOR: ROLI I ANALISTIT LIGJOR

A. Hulimtim i përgjithshëm i kornizës ligjore

Analisti ligjor i MVZ-së ka përgjegjësinë kryesore për të vlerësuar shkallën në të cilën korniza kushtetuese dhe ligjore e një vendi përmbush zotimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare për pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në jetën politike dhe proceset zgjedhore. Kjo duhet të jetë pjesë integrale e vlerësimit më të përgjithshëm të kornizës ligjore të ndërmarrur si pjesë e punës të secilit MVZ. Analisti ligjor duhet të vlerësojë nëse zgjedhjet po mbahen në kontekst ligjor që garanton të drejtat e çdo personi në baza të barabarta dhe jodiskriminuese dhe se institucionet e shtetit sigurojnë që këto garanci të jenë implementuar në mënyrë efektive dhe zbatohen. Metodologjia për ndërmarrjen e vlerësimit të procesit zgjedhor në tërësi është përshkruar në *Udhëzimet për Rishikimin e kornizës ligjore për zgjedhjet*,⁴ botuar nga ODIHR-i në

janar të vitit 2001. Ky kapitull përqendrohet më specifiku në atë se a thua konteksti ligjor hedh themelet për barazi gjinore në jetën publike. Vlerësimi duhet të ketë parasysh veçanërisht nëse kuadri ligjor - që lidhet me gjininë dhe zgjedhjet - është në përputhje me zotimet e OSBE-së në kuadrin e Dokumentit të Kopenhagës, të Dokumentit të Moskës, dhe Kartës Evropiane të Sigurimit. Ajo gjithashtu duhet të vlerësojë nëse kuadri ligjor dhe zbatimi i tij janë në përputhje me standardet e tjera ndërkombëtare dhe detyrimet në të cilat është obliguar shteti në fjalë. Në veçanti, kjo mund të përfshijë dispozitat përkatëse të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Traktatit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, dhe Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave. Këto standarde ndërkombëtare kanë qenë miratuar nga shumica e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.

⁴ Teksti mundet të gjindet në uebfaqen e ODIHR-it në www.osce.org/odihr

B. Garancitë kushtetuese të të drejtave të grave

Hap i parë në vlerësimin e ndikimit të kornizës ligjore për gratë dhe zgjedhjet është të përcaktohet shkalla në të cilën kushtetuta e një shteti garanton të drejta të barabarta njerëzore për gratë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje politike nga gratë, dhe lirinë nga diskriminimi në bazë të gjinisë. Në qoftë se kushtetuta hesht, është e paqartë, ose më pak se avancuese për të drejta të barabarta të grave, kjo mund të ofrojë njohuri lidhur me gjendjen e përgjithshme të gruas në shoqëri, dhe në arenën politike.

Kushtetutat e shumicës së vendeve në mbarë botën, dhe në mesin e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së në veçanti, kanë dispozita që garantojnë të drejtat e njeriut. Megjithatë, ndryshimet e mëdha midis shteteve mund të pasqyrojnë traditat politike dhe kulturore, në bazë të së cilit realiteti i të drejtave të barabarta për femrat ngec tepër prapa premtimeve, madje edhe në vendet ku barazia është e parashikuar me Kushtetutë. E përbashkët për kushtetutat është që të përfshijnë garanci se qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe që posaçërisht ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë. CEDAW obligon Shtetet anëtare të “mishërojnë parimin e barazisë së burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose legjislacionet tjera të përshtatshme...”⁵

MVZ duhet të përcaktojë nëse ekzistojnë dispozita kushtetuese, të cilat në mënyrë specifike ose potencialisht mund të kenë ndikim negativ në

barazinë dhe/ose pjesëmarrjen politike të grave. Për shembull, MVZ duhet të shënojë nëse kushtetuta garanton jo vetëm të drejtën për të votuar, por edhe të drejtën e të gjithë qytetarëve të kandidohen për pozitën dhe për t'u zgjedhur.

C. Ligjet e tjera që ndikojnë në barazinë dhe pjesëmarrjen politike të gruas

Përtej kushtetutës, të drejtat e barabarta për gratë dhe shtrirja e pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor mund të ndikohen nga një shumëllojshmëri e ligjeve të tjera. Prandaj mund të jetë e dobishme të shqyrtohen ligjet e tjera për të fituar njohuri në kontekst më të gjerë ligjor që mund të ndikojnë në aftësinë e grave për të marrë pjesë plotësisht në jetën publike, në veçanti si drejtues dhe vendimmarrës. Këto mund të përfshijnë:

- ▶ Ligjin zgjedhor dhe ligje të tjera që lidhen drejtpërdrejt me procesin zgjedhor, të tilla si ligji mbi partitë politike. Secila dispozitë haptazi diskriminuese në ligjet e tilla duhet vënë në pah nga MVZ. MVZ gjithashtu duhet të konsiderojë nëse ndonjë prej dispozitave të këtyre ligjeve mund të veprojnë në mënyrë indirekte në dëm të grave. Për shembull, kërkesa që kandidatët të prezantojnë një numër jashtëzakonisht të lartë të nënshkrimeve për t'u kualifikuar për votim, ose kërkesa për depozit të konsiderueshëm monetar për kandidatët mundet në mënyrë jo-proporcionale të

⁵ CEDAW, Neni 2 (a). Tekstin e këtij dhe dokumenteve tjera për të drejtat e njeriut të KB mundeni ta gjeni në www.unhchr.ch

ndikojë të gratë në shtetet ku femrat tradicionalisht nuk kanë marrur pjesë aktive si kandidatë ose ku të ardhurat e grave janë dukshëm më të ulëta se të meshkujve. Disa ligje zgjedhore apo ligje të partive politike mund të përcaktojnë kuota për gratë; këto diskutohen në kapitullin e ardhshëm të këtij manuali, pasi që kuotat nuk janë çështje rreptësisht ligjore;

- ▶ Nëse ekziston ligj i veçantë që është në fuqi që adreson barazinë e burrave dhe grave, duhet gjithashtu të shqyrtohen për tu vlerësuar nëse dhe si ai ndikon mbi procesin zgjedhor. Në veçanti, nëse dispozitat e aktit të veçantë janë në kundërshtim me aspektet e ligjit zgjedhor, mospërputhjet duhet të shqyrtohen dhe vlerësohen;
- ▶ MVZ duhet të vlerësojë, nëse është e mundur, në masën në të cilën ekzistojnë dispozitat kundër diskriminimit në ligjet kombëtare në lidhje me gratë, nëse këto janë implementuar në mënyrë efektive dhe nëse zbatohen, dhe efektet e dispozitave të tilla në procesin zgjedhor;
- ▶ Nëse një shtet është anëtar i ICCPR, CEDAW, ose traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, analist ligjor i MVZ duhet të përcaktojë nëse këto marrëveshje janë vetë-ekzekutuese sipas ligjit vendas dhe nëse ata kanë status më të lartë se ligji i shtetit brenda kornizës ligjore kombëtare. Zbatimi i tyre duhet të merret parasysh si pjesë e analizës së kornizës së përgjithshme ligjore të MVZ-së dhe zbatimit të tyre.

Kur dëshmitë sugjerojnë se roli i grave në jetën publike dhe udhëheqjen është dukshëm i ulët, shqyrtimi i ligjeve të tjera mund të tregojë arsyet pse. Për shembull, ligjet lidhur me statusin personal, familjes dhe kujdestarisë, punësimit, taksave, trashëgimisë dhe pronës, dhe kodet penale mund të ofrojnë njohuri.

D. Pengesat potenciale të mbrojtjes ligjore të të drejtave të grave

Në mënyrë që të sigurohet barazia e grave në procesin politik, është e rëndësishme të merret parasysh jo vetëm korniza ligjore, por edhe shtrirja në të cilën ligjet garantojnë barazinë e grave janë duke u implementuar dhe zbatuar në mënyrë efektive. Është e qartë se, vlera e legjislacionit që garanton të drejtat e grave është zvogëluar në qoftë se ligjet nuk zbatohen, në qoftë se ato janë të rrezikuara nga interpretimi subjektiv, ose në qoftë se gratë nuk janë në dijeni të tyre. Idealisht, institucionet e ngarkuar me zbatimin e të drejtave të njeriut dhe ligjet e barazisë gjinore duhet të kuptojnë parimet e përfshira dhe rëndësinë e roleve të tyre në përparimin e tyre. Kjo nuk mund të ndodhë gjithmonë, megjithatë, veçanërisht në shoqëritë ku qasjet tradicionale kulturore janë ngulitur edhe më tutje, ose në vendet në tranzicion ku reformat e gjyqësisë dhe të forcave të policisë nuk mund të ketë mbajtur ritëm me reformën e kodeve legjislativë.

Madhe edhe kur ekzistojnë ligje të përshtatshme, ato ndonjëherë nuk

zbatohen, sepse nuk ka agjenci që është e caktuar si përgjegjëse në mënyrë të qartë, ose sepse ata që janë përgjegjës nuk kanë autoritet ligjor ose mekanizma administrative dhe burimet për të realizuar atë gjë. Ndonjëherë, zyrtarët thjesht dështojnë të veprojnë. Në raste të tjera, procesi i apelit dështon që të sigurojë mjete juridike kuptimplote. Në kontekstin e zgjedhjeve, vëzhguesit duhet të jenë vigjilent për rrethanat e tilla.

Zbatimi joadekuat ose selektiv i ligjeve mund të veprojë më shumë në dëm të grave se meshkujve në disa raste. Për shembull, në qoftë se kufijtë mbi shpenzimet e fushatës nuk janë zbatuar në mënyrë të përshtatshme, kjo mundet në mënyrë të padrejtë të shkaktojë disavantazh për gratë kandidatët në shtetet me të ardhura qartë të pabararta midis burrave dhe grave. Në vendet ku frikësimi i votuesve ose kandidatëve është problem, MVZ duhet të vlerësojë nëse kjo ndikon më shumë te gratë ose te burrat. Gratë mundën gjithashtu të jenë në pozitë të pafavorshme në qoftë se legjislacioni zgjedhor është aq i paqartë sa që është i ndjeshëm ndaj interpretimeve manipuluese. Për shembull, nëse një ligj është i paqartë se si duhet të verifikohen

nënshkrimet për petitionin e emërimit, ai mund të çojë në atë që kritere më të rrepta të përdoren për disa kandidatë sesa për të tjerët. MVZ duhet të jetë vigjilent ndaj çdo praktike të tillë dhe duhet të shënojë në qoftë se ata duket të jenë përdorur në mënyrë të pashembullt për të skualifikuar kandidatët femra. Ndonjëherë, gratë nuk kanë njohuri të mjaftueshme për të drejtat e tyre dhe as për mënyrat e mjetin ligjor të disponueshme për ta në rast kur të drejtat e tyre janë cënuar. MVZ prandaj duhet të mundohet të vlerësojë se athua gratë kanë qasje adekuate deri te informatat ligjore, ndihma ligjore dhe mjetet juridike efektive. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme gjatë periudhës kohore në të cilën ankesat e zgjedhjeve duhet të ngrihen dhe të zgjidhen, e cila është shpesh shumë e shkurtër.

Ankesave zgjedhore dhe apelet janë gjithmonë çështje kryesore për MVZ. Si pjesë e analizave të tyre e proceseve të ankesave dhe apeleve, MVZ duhet të shqyrtojë se a thua këta procese janë njëlloj të përgjegjshme dhe efektive për votuesit dhe kandidatët femra, siç janë edhe për meshkujt.

DISPOZITAT KUSHTETUESE

- A thua garanton kushtetuta të drejta të barabarta për burrat dhe gratë? A ka ndonjë dispozitë specifike që garanton barazinë e tyre? A thua ju garanton kushtetuta burrave dhe grave të drejta të barabarta për tu kandiduar për poste publike, për të mbajtur zyra publike, ose për të shërbyer në postet qeveritare?
- A ekziston ndonjë dispozitë kushtetuese e cila ka gjasa të cenojë ndonjë të drejtë të grave ose në mënyrë tjetër të shkaktojë disavantazh për gratë?

LIGJET E TJERA

- A thua ndonjë ligj që lidhen drejtpërdrejt me zgjedhjet ngërthen dispozita që mund të shkaktojnë disavantazh për gratë?
- A ekziston ndonjë akt i veçantë që trajton në mënyrë specifike barazinë e grave dhe burrave?
- Nëse mundësohet shqyrtim i ligjeve të tjera, a thua ndonjëri prej tyre është në kundërshtim me trajtimin e barabartë të dispozitave obliguese në kushtetutë apo instrumentet ndërkombëtare? Nëse po, cilat ligje? Ligjet e statusit personal? Ligjet familjare? Ligjet për trashëgimi, pronë, ose ligjet e taksave? Kodi penal? Të tjerë?

GRUAJA DHE SISTEMI LIGJOR

- A ka dëshmi apo arsye për të besuar se gratë nuk kanë trajtim të barabartë përpara ligjit? Nëse po, çfarë anësime janë reflektuar?
- Në kontekstin e zgjedhjeve, a thua ka kohëve të fundit ose në rrjedhë raste gjyqësore që përfshijnë kandidatët femra, përfaqësues të medimeve, qeverisë ose nëpunës të organeve zgjedhore, ose OJQ-ve të grave? Nëse po, cilat ishin çështjet qendrore? Në qoftë se një rast tanimë është zgjidhur, çfarë ishte rezultati?

3.



SISTEMI ZGJEDHOR DHE ADMINISTRATA ZGJEDHORE: ROLI I ANALISTIT ZGJEDHOR

Analisti zgjedhor i MVZ ka përgjegjësi në kryesore për vlerësimin se si strukturat zgjedhore të një vendi ndikojë në pjesëmarrjen politike dhe të drejtat e barabarta të grave. Kjo përfshin llojin e sistemit zgjedhor dhe çështje të tilla si regjistrimi i votuesve, regjistrimin e kandidatëve, dhe procesin e votimit. Si pjesë e vlerësimit të tij të funksionimit normal dhe efektiv të administratës zgjedhore, MVZ duhet të vlerësojë masën në të cilat komisionet zgjedhore të niveleve të ndryshme përfshijnë gratë në përbërjen dhe udhëheqjen e tyre dhe masë në të cilën ata janë të vetëdijshëm për konsiderimet gjinore dhe konsiderimit të tyre në punën e tyre. Seksionet në vijim ofrojnë udhëzime të përgjithshme mbi çështjet kryesore që duhet shqyrtuar.

A. Sistemet zgjedhore

Një lidhje reciproke duket se ekziston midis llojit të sistemit zgjedhor dhe avancimit të grave si zyrtarë të zgjedhur, madje edhe në shtetet ku statusi i

zhvillimit ekonomik dhe tradita kulturore nuk angazhohen tepër fortë për avancime të tilla. Në përgjithësi, numër paksa më i madh i grave priren të jenë të zgjedhura me sistem proporcional në krahasim me sistemin “i pari kalon në post” të shumicës ose sistemin pluralist ose nën sistemet e kombinuara. Megjithatë, një sistem i caktuar zgjedhor jo gjithmonë do të mbështetë rezultate pozitive për kandidatët femra.

Edhe pse nuk është qëllimi i Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të promovojë ndonjë lloj të sistemit zgjedhor në favor të tjetrit, MVZ duhet të jetë i vetëdijshëm për ndërlikimet specifike për pjesëmarrjen e suksesshme të grave në llojet e ndryshme të sistemeve zgjedhore. Më me rëndësi është se, MVZ duhet të përcaktojë nëse ekzistojnë elemente të sistemit zgjedhor të vendit që në mënyrë specifike rrisin mundësitë për gratë, ose që krijojnë barriera për ta, ose diskriminojnë kundër femrave.

1. Sistemet e përfaqësimit proporcional

Sistemet e përfaqësimit proporcional -- në të cilin partitë paraqesin listat e kandidatëve - sigurojnë nxitje më të madhe për partitë që të përfshijnë më shumë gra në mesin e kandidatëve të tyre për të tërhequr një bazë më të gjerë të mbështetjes së votuesve. Sistemet proporcionale janë edhe më të favorshme për zbatimin e masave afirmative se sa që janë sistemet e shumicës. Pa presionin e fituarit në një sistem të shumicës/pluralizmit ku “fituesi fiton gjithçka”, partitë mund të jenë më të disponuara që të paraqesin një listë më të larmishme të kandidatëve që mund të përfshijnë më shumë gra. Listat e kandidatëve të mundshëm ofrojnë më shumë mundësi potenciale për partitë që të jenë gjithnjë e më të përgjegjshëm në lëvizjet e grave, ose përpjekjet e lobimit, si brenda partisë ashtu edhe në mesin e elektoratit të gjerë.

Sistemet e përfaqësimit proporcional sigurojnë mundësi të madhe për partitë e vogla me agjendat të përqendruara në çështjet që do të lindin më vonë. Në disa shtete të OSBE-së, kjo ka dërguar deri te formimi i partive të grave.

2. Sistemet e shumicës/pluralizmit

Në krahasim me sistemet e përfaqësimit proporcional, sistemet ku një mandat fituesi i merr të gjitha – ose

sistemet e shumicës/sistemet pluraliste - mund të bëjnë shumë më të vështirë që gratë të dalin si kandidatë. Sistemet e tilla zakonisht ofrojnë pak stimul për partitë për të nxitur një grua, nëse një kandidat mashkull shihet si person i cili maksimizon gjasat e partisë për të fituar mandatin në një zonë të caktuar votimi.

Në sistemet e pluralizmit/shumicës, mbajtja e posteve shpesh mund të pengojë çdo hyrje të re në sferën politike, duke përfshirë këtu edhe gratë. Mbjatësit e posteve gëzojnë përparësi të tilla si njohja e emrit dhe drejtim nga një pozitë e ndikimit të rritur, dhe ata janë shpesh në pozitë më të favorshme për grumbullimin e fondeve. Në shumë vende, avantazhet e të qënit mbajtës i pozitës shumë e shton perspektivën për ri-zgjedhje. Dominimi tradicional i burrave si mbajtës të mandateve dhe tendenca për të ri-zgjedhur mbajtësit e mandateve mund të krijojnë pengesa për kandidatët e rinj, duke përfshirë këtu edhe gratë. Megjithatë, nga ky fenomen mund të përfitojnë në mënyrë të njëjtë edhe gratë mbajtëse të posteve.

Në përgjithësi, zgjedhjet e asamblesë lokale janë të bazuara në sistemet e shumicës/ sistemet e pluralizmit. Pasi që shfaqja e grave në prominencën politike kombëtare në një mënyrë do të burojë nga masa e grave që mbajnë mandate në nivel lokal, numri i grave që mbajnë postet lokale mund të jetë një barometër për të ndihmuar vlerësimin e mundësive të grave për të ardhmen në nivel kombëtar.

B. Elementet e proceseve zgjedhore të cilat ndikojnë pjesëmarrjen e grave

Aspektet standarde të sistemeve zgjedhore - të tilla si pragu, madhësia e zonës së votimit, ose llojet e listave të kandidatëve - mund të kenë ndikim të rëndësishëm mbi perspektivat zgjedhore të grave. Si pjesë e analizave të tyre të procesit zgjedhor, MVZ duhet të vlerësojë nëse këto dhe aspektet e tjera të një sistemi zgjedhor kanë vepruar në të mirë të grave kandidatë ose kanë krijuar pengesa për ta.

Pragjet: Në sistemet proporcionale, pragu përcakton një përqindje minimale të votave që duhet të fitohen që një parti të merr pjesë në shpërndarjen e vendeve. Sa më i lartë është pragu, aq më vështirë është për partitë e vogla të fitojnë përfaqësim në parlament. Edhe pse nuk ka standarde ndërkombëtare që rregullojnë nivelin e pragut, pragu në shtetet anëtare të OSBE-së nuk kalon 5 përqind. Pragjet e niveleve më të larta duhet të vlerësohen me kujdes nga MVZ, pasi ata mund të rezultojnë në një numër tepër të madh të votave të “tretura” ose vota të partive të cilat nuk do të fitojnë asnjë vend në parlament.

MVZ duhet të vlerësojë se si pragu ndikon në përfshirjen e grave në listat e kandidatëve të partive politike. Një parti e vogël me një premtim të suksesit të kufizuar mund të jetë më e prirur për të vendosur kandidatët kryesor të tij meshkuj në pozitat e larta të listës së kandidatëve, duke hequr gratë nga konkurrimi. Nga ana tjetër, pasi që pragu ka potencial të eliminojë

disa parti të vogla, rezultatet mund të shkaktojnë shpërndarjen e vendeve të kandidatëve më poshtë në listat e partive më të mëdha, duke siguruar një mundësi më të madhe që këto vende t’ju përkasin grave.

Madhësia e zonës së votimit: madhësia e zonës së votimit është një element tjetër që duhet të vlerësohet. Në sistemet proporcionale, madhësia e zonës së votimit është e lidhur me numrin e kandidatëve të zgjedhur nga një zonë e vetme zgjedhore ose nga një juridiksion. Në përgjithësi, sa më e madhe madhësia e zonës së votimit – ose sa më shumë përfaqësues zgjedhen nga një zonë e vetme e votimit – aq më shumë gjasa ka që gratë që do të nominohen si kandidatë do të zgjedhen. Parimi është i njëjtë si ai te sistemet proporcionale në përgjithësi: atje ku madhësia e zonës së votimit është më e madhe, presionet lidhur me konkurrencën e fituesit të vetëm i cili fiton gjithçka eliminohen, duke ju dhënë një nxitje partive politike më të madhe të emërojë pëpërbërje të ndryshme të kandidatëve, përfshirë këtu edhe gratë.

Në të kundërtën, në sistemet e shumicës/sistemet e pluralizmit, madhësia më e vogël e zonës së votimit do të thotë se më shumë vende janë në dispozicion, duke hapur më shumë mundësi për gratë kandidatë.

Llojet e listave: Lloji i listës së partisë i shfrytëzuar në një shtet gjithashtu mund të ndikojë në përfaqësimin e grave dhe duhet të vlerësohet në këtë kontekst. Një sistem i listës “të mbyllur” ka kandidatë të listuara në një mënyrë të caktuar që nuk jant subjekt i ndryshimit nga ana e votuesve. Në

përgjithësi, sistemet e listave të mbyllura janë më të favorshme për gratë kandidatë, me kusht që ato të jenë të vendosur mjaft lartë në listat e tilla. Sistemi i listave “të hapura” ju lejon votuesit të ndryshojnë radhitjen e kandidatëve në listat me rangimin e tyre ose me të shprehurit e preferencës për disa kandidatë mbi të tjerët në listën e partive. Në shtetet me lista të hapura, votuesit – përfshirë këtu edhe votuesit femra - kanë qenë të prirë të favorizojnë kandidatët meshkuj, që rezultojnë me atë se shumë femra kandidatë përfundojnë në pozitën më të ulët në listat e kandidatëve se sa do të ishte rasti me listat e mbyllura. Megjithatë, nga listat e hapura mund të përfitojnë nganjëherë gratë kandidatë në qoftë se grupet e mbështetjes mund të mobilizohen në mënyrë efektive pas grave të veçanta ose në qoftë se votuesit në përgjithësi mund të mobilizohen për të mbështetur gratë kandidatë.

C. Kuotat dhe veprimet afirmative

Kuotat: Në sistemet me përfaqësim proporcional, duke përfshirë listat e kandidatëve, gjasat për gratë rriten shumë kur ligji specifikon nivelet minimale të përfaqësimit të të dy gjinive në listën e kandidatëve të secilës parti ose kur palët vullnetarisht miratojnë politikën e brendshme për promovimin e grave si kandidatë.

OSBE-ja nuk ka qëndrim zyrtar mbi kuotat ose mbi përfaqësimin e detyrueshëm ose vullnetar minimal për secilën gjini. Nuk ka standarde

ndërkombëtare që kërkojnë apo ndalojnë kuotat. Shumica e madhe e Shteteve anëtare të OSBE-së nuk kanë as kuotat e detyrueshme dhe as vullnetare si pjesë e sistemeve të tyre zgjedhore. Megjithatë, në raste në të cilat vetë OSBE-ja ka ndihmuar në hartimin dhe administrimit të sistemeve zgjedhore - për shembull, në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë - kuota e obligueshme gjinore ka qenë përfshirë në sistem. Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave përcakton se miratimi “nga Shtetet Anëtare të masave të përkohshme të veçanta që synojnë përshtetimin de facto të barazisë midis burrave dhe grave nuk do të konsiderohet diskriminim...”⁶

Si pjesë e analizave të tij të sistemit zgjedhor, MVZ duhet të vlerësojë të gjitha masat e detyrueshme ose vullnetare për veprime pozitive ose karakteristika të tjera të tilla që kanë qenë të përfshirë në sistemin zgjedhor. MVZ duhet të përcaktojë shkallën në të cilën secila veçori e tillë të ketë sukses apo dështojë në avancimin e pjesëmarrjes së grave. Nëse masat e veçanta me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes të grave nuk përmbushin objektivat e tyre, MVZ duhet të përpiqet të identifikojë faktorët që shkaktojnë mungesën e suksesit.

Kuotat ligjore kanë ndikimin më të madh në zgjedhjen e kandidatëve femra, sepse ato zbatohen për të gjitha palët, dhe ligji zakonisht siguron një bazë për zbatimin e vendimeve. Në të njëjtën kohë, një kuotë e imponuar për kandidatët femra në listat e partive ndoshta nuk do të jetë veçanërisht

⁶ CEDAW, Neni 4.1

efikase në sigurimin e zgjedhjeve të grave nëse ligji gjithashtu përcakton se si kandidatët meshkuj dhe femra duhet të jenë të vendosur në listë. Nëse gratë janë vendosur tepër poshtë në listat, edhe kuotat e mëdha nuk mund të rezultojnë me zgjedhjen e tyre. Një listë “zik-zake” - në të cilat burrat dhe gratë ndërrohen në mënyrë të barabartë - ofron mundësi më të mira për gratë që të zgjedhen.

Kur ekziston kërkesë për kuotë, vëzhguesit duhet të shënojnë nëse janë të përfshira kushtet që diktojnë mënyrën në të cilën janë plotësuar vendet e lira, kandidati zgjidhet, kur ai nuk e merr postin ose largohet nga zyra para përfundimit të mandatit të saj. Për shembull, ligji për kuotë mund të kërkojë që nëse një grua jep dorëheqjen ose largohet nga zyra para kohe, kandidati i cili do ta zëvendësojë duhet të jetë një grua tjetër në dispozicion në listën e kandidatëve. Pa ndonjë procedurë të tillë, efektiviteti i ligjit të kuotave mund të neutralizohet me kalimin e kohës, sidomos nëse gratë janë nën presion për të dhënë dorëheqje.

Diskriminimi pozitiv: Përtej kuotave ligjore, në disa shtete partitë politike kanë miratuar masat e diskriminimit pozitiv vullnetar për të rritur numrin e grave kandidate. Funkcionimi dhe efektiviteti i çfarëdo mase të tillë duhet të vlerësohet nga MVZ.

Një strategji tjetër e diskriminimit pozitiv synon kah krijimi i vendeve “të rezervuara,” ku një numër i caktuar i vendeve në organin legjislativ është caktuar për tu plotësuar vetëm nga një grup i veçantë, të tilla siç janë gratë. Sistemet e tilla, të cilat janë përdorur

në një numër të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, garantojnë një nivel minimal të përfaqësimit të grave në parlamentet. Disa nga kundërshtarët e sistemeve të tilla kanë argumentuar se koncepti i vendeve të rezervuara, megjithëse për qëllim të përcaktimit të nivelit minimal për pjesëmarrjen e grave në organet e zgjedhura, në praktikë ka rezultuar në ngritjen e një kufiri të sipërm psikologjik për pjesëmarrjen e grave.

D. Pjesëmarrje në administratën zgjedhore

MVZ duhet të vlerësojë shkallën në të cilën gratë janë anëtarë të organeve përgjegjëse për zhvillimin e zgjedhjeve dhe që mbajnë pozita të lidërshipt në këto organe. Kjo duhet të përfshijë komisionin qendror zgjedhor, si dhe organet zgjedhore të nivelit më të ulët. Përtej statistikave, MVZ gjithashtu duhet të vlerësojë nëse gratë me të vërtetë funksionojnë si drejtues dhe vendimmarrës dhe sa ndikim kanë në udhëheqjen apo në postet e tjera të cilat i mbajnë. Më tej, duhet të bëhet një vlerësim për shtrirjen në të cilën komisionet zgjedhore në të gjitha nivelet janë të vetëdijshëm për vlerësimet gjinore dhe të marrin ato parasysh në punën e tyre.

E. Regjistrimi i votuesve

Një nga detyrat e MVZ është të vlerësojnë saktësinë e regjistrave (listave) të votuesve dhe aftësinë e administratës së regjistrimit të votuesve, dhe

të bëjnë rekomandime për atë se si të metat mund të korrigjohen. MVZ duhet të përpiqet të vendosë ndarjen proporcionale gjinore të listës së votuesve, megjithëse kjo jo gjithmonë mund të jetë e mundur. Numri i burrave dhe grave duhet të jetë përafërsisht i barabartë, edhe pse nuk është e pazakontë që të ketë pak më tepër gra. Për aq sa është e mundur, është gjithashtu e dobishme të bëjmë disa krahasime rajonale. Nëse gratë duket se janë të nën-përfaqësuara në ndonjë rajon të veçantë, vëzhguesit duhet të përpiqen të përcaktojnë rrethanat të cilat e shkaktojnë atë anomali. Ata mund të shpjegohen lehtë, ose mund të tregojnë kushtet ekzistuese sociale ose institucionale që shtyjnë gratë prapa nga pjesëmarrja e plotë në jetën publike. Varësisht nga rrethanat, vëzhguesit mund të kenë arsye të mirë për të ndjekur pikat shtesë të hetimit.

Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve duhet të jenë të vetëdijshëm për një numër faktorësh që mund të nxjerrin gratë në disavantazh në lidhje me regjistrimin si votues dhe duhet këtë ta kenë parasysh gjatë analizimit të sistemeve dhe procedurave të regjistrimit të votuesve. Disa nga këto kanë të bëjnë me shtetet me sistem “pasiv” të regjistrimit, dmth, sistemet në të cilat autoritetet civile hartojnë listat e votuesve automatikisht bazuar në shënime të vendbanimeve qytetare dhe shënimeve të tjera. Të tjerat kanë të bëjnë me vendet me sistemet “pozitive” të regjistrimit, në të cilin votuesit vetë duhet të aplikojnë për të qenë në listat e votuesve. Disa pengesa mund të jenë praktike ose burokratike nga natyra ose për shkak të mangësive

teknike ose kufizimeve të kapaciteteve administrative, ndërsa të tjerat mund të jenë të varura nga kushtet sociale apo kontekstuale të cilat mund të paraqesin vështirësi të veçantë për gratë.

Ka një numër faktorësh të tillë që duhet t’ju tërheqin vëmendjen vëzhguesve:

- ▶ Pasi që emrat dhe vendbanimet e grave ndryshojnë shpesh si rezultat i martesës, është e rëndësishme që të vendoset një sistem i cili do të kuptojë këto ndryshime në mënyrë që të mos i anashkalojë gratë e posa martuara. Gjithashtu, pasi që të dhënat për vendbanimin zakonisht janë të regjistruar nën emrin e kreut mashkull të familjes, është veçanërisht e rëndësishme në vendet me sisteme të regjistrimit pasiv që femrat e varura të përfshihen në regjistrat e votuesve vizatuar nga listat e anëtarëve të familjeve;
- ▶ Veçanërisht në rastin e sistemeve të regjistrimit pozitiv, një çështje e rëndësishme mund të lidhet me lehtësimin e qasjes në zyrat e regjistrimit. Orari i punës, koha e udhëtimit, dhe distanca deri te zyrat përkatëse mund të jenë me interes të veçantë për gratë, veçanërisht për gratë që kujdesen për fëmijët e vegjël. Komoditeti për qasje në qendrat e regjistrimit të votuesve mund të jetë relevant gjatë çfarëdo periudhe të shqyrtim publik që është ofruar për votuesit për të kontrolluar listat e votuesve për të siguruar se ata janë të përfshirë. Vëzhguesit duhet të vlerësojnë nëse është dhënë njoftim i mjaftueshëm për datat dhe kohëzgjatjen e periudhës së shqyrtimit publik, dhe nëse

njoftimi i tillë ofrohet në një formë të kuptueshme për gratë, duke përfshirë ata të lidhura në shtëpi me fëmijë të vegjël;

- ▶ Vëzhguesit duhet të vlerësojnë efikasitetin e informimit publik në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe të drejtën për të votuar. Kur femrat janë të nën përfaqësuar në listat e votuesve, vëzhguesit duhet të përcaktojnë nëse administratorët e zgjedhjeve, autoritetet lokale, udhëheqësit e komunitetit, ose OJQ-të janë duke zhvilluar ndonjë program të veçantë të projektuar për të arritur deri te gratë dhe për të inkurajuar dhe lehtësuar pjesëmarrjen e tyre;
- ▶ Në shoqëritë pas konfliktit, është e rëndësishme që autoritetet të përfshijnë dispozita që personat e zhvendosur të jenë në gjendje të votojnë. Një çështje kritike për personat e zhvendosur është qasja e tyre deri te dokumentet e identitetit ose dokumentet e vendbanimit të nevojshme për regjistrim dhe për votim. Shumë persona të zhvendosur mund të kenë humbur dokumentet e tyre duke u larguar ose duke ikur nga armiqësitë ose kur detyrohen të largohen nga komunitetet e tyre. Në raste të tilla, gratë e zhvendosura mund të ngurrojnë veçanërisht të nxjerin dokumentet

e reja ose regjistrimin nga frika prej kërcënimit. Gratë në veçanti mund të frikësohen se regjistrimi për të votuar në komunitetin e tyre të mëparshëm mund të rezultojë në humbje të drejtave të tyre lidhur me vendbanimin në komunitetin e tyre aktual për veten dhe fëmijët e tyre.

Në të gjitha shtetet, është gjithashtu e rëndësishme të kuptoni modelet tradicionale kulturore që mund të pengojnë gratë të regjistrohen për të votuar dhe për pjesëmarrje në zgjedhje. Gjuha ose pengesat e shkrimit dhe leximit mund të kufizojnë qasjen e votuesit për regjistrim dhe mund të prekin gratë në mënyrë dis-proporcionale bazuar në shkallën kombëtare të shkrimit dhe leximit. Gratë që janë anëtare të grupeve të pakicave mund të jenë veçanërisht me gjasë të ndikuara. Vëzhguesit duhet gjithashtu të jenë të ndjeshëm ndaj traditave fetare, kombëtare, etnike apo kulturore që mund të pengojnë regjistrimin e grave. Aty ku ekzistojnë kushte të tilla, vëzhguesit duhet të përcaktojnë se çfarë përpjekje bëhen, nëse bëhet ndonjë, për tu tejkaluar kushtet që parandalojnë gratë nga regjistrimi si votues ose në ndonjë mënyrë tjetër të marrin pjesë në procesin zgjedhor, dhe në qoftë se këto përpjekje kanë ndonjë efekt pozitiv.

PIKA PËR SHOYRTIM: SISTEMI ZGJEDHOR DHE ADMINISTRATA ZGJEDHORE:

SISTEMI I ZGJEDHJEVE

- Si ndikon zgjedhja e sistemit të shumicës/sistem pluralist ose të sistemit të përfaqësimit proporcional në pjesëmarrjen dhe kandidaturën e grave në zgjedhje?
- A thua aspekte të veçanta të sistemit ndikojnë në gjasat e grave kandidate?
- Madhësia e zonës së votimit?
- Pragjet?
- Votim me lista të hapura ose të mbyllura? Nëse përdoret listë e hapur, a thua ajo funksionon për avantazhin apo disavantazhin e grave kandidate?
- Nga rezultatet e zgjedhjeve, si duket se sistemi zgjedhor ka ndikuar në zgjedhjen e kandidatëve femra?

KUOTAT DHE DISKRIMINIMI POZITIV

- A përfshin ligji çfarëdo kuote ose dispozita të diskriminimit pozitiv për të siguruar që të zgjidhen femra? Nëse po, çfarë lloj masash janë të siguruarat? Sa është niveli i secilës kuote?
- A thua ligji obligon vendosjen e grave në pozicione fituese në listat? (Si rregull e përgjithshme, postet fituese zakonisht konsiderohen 10 vendet e para në listë).
- Si plotësohen vendet e lira nëse gruaja tërhiqet nga lista?
- Si sillen zyrtarët ndaj listave të kandidatëve që nuk plotësojnë kuotat?
- A janë vënë mënjanë apo rezervuar vende për gratë? Nëse po, sa?
- A thua masat e diskriminimit pozitiv funksionojnë për të mirën e grave? A ka difekte ose gabime që minojnë ndikimin e tyre?

PJESËMARRJA NË ADMINISTRATËN ZGJEDHORE

- Në çfarë mase janë gratë anëtarë të komisionit qendror zgjedhor dhe organeve tjera më të ulëta të administratës zgjedhore?
- Në çfarë mase gratë mbajnë pozitat udhëheqëse në organet e administratës zgjedhore?
- Në çfarë mase gratë me të vërtetë funksionojnë si drejtues dhe marrin vendime në organet e administratës zgjedhore? Sa ndikim të vërtetë kanë ata në udhëheqje apo në postet e tjera të cilat i mbajnë?
- Deri në çfarë mase janë komisionet zgjedhore në të gjitha nivelet të vetëdijshëm për vlerësimet gjinore dhe marrjen e tyre në konsiderim në punën e tyre?

REGJISTRIMI I VOTUESVE

- A thua ndarja proporcionale e meshkujve dhe femrave në listat e votuesve reflekton popullsisë në përgjithësi?
- A ka qarqe ose rajone në të cilat gratë është qartë që janë të papërfaqësuar në mënyrë të konsiderueshme? Nëse po, cilat janë rrethanat?
- A ka mangësi ose pengesa sistematike në procesin e regjistrimit të votuesve që janë të pafavorshme për gratë?
- A thua autoritetet mbajnë shënime të sakta të ndryshimeve të emrit apo adresës?
- A janë zyrat e regjistrimit të vendosura në mënyrë të përshtatshme për qasje të lehtë?
- A është bërë informimi në dispozicion në lidhje me regjistrimin në mënyrë të kuptueshme për gratë?
- A thua zyrtarët ose OJQ-të përfshihen në aktivitetet e regjistrimit të votuesve në terren për gratë?
- A ka rrethana të veçanta që kufizojnë qasjen e grave deri te dokumentet?
- A ka ndonjë pengesë gjuhësore ose të shkrimit dhe leximit që në mënyrë dis-proporcionale ndikon te gratë?
- A ekzistojnë tradita kulturore që mund të pengojnë regjistrimin ose pjesëmarrjen e grave? Zakone etnike ose kombëtare? Tradita lidhur me fenë? Tradita patriarkale të përgjithshme? A ndërmarrin autoritetet masa për tejkalimin e tyre?

4.



PARTITË POLITIKE DHE AVANCIMI I GRAVE: ROLI I ANALISTIT POLITIK

Analisti politik i MVZ ka përgjegjësinë kryesore për vlerësimin e nivelit dhe natyrës së pjesëmarrjes politike të grave në zgjedhje të caktuar. Kjo përfshin rolin e grave në partitë politike dhe si kandidatët. Gjithashtu përfshin shkallën në të cilën partitë politike integrojnë gratë dhe çështjet e grave në aktivitetet e tyre dhe strategjitë e fushatës të tyre.

A. Organizimi i brendshëm dhe implikimet për gratë

Me përjashtim të kandidatëve të pavarur, shumica e grave që aspirojnë për poste të zgjedhur janë të varura nga strukturat e partive politike për propozimet e tyre dhe mbështetjen e tyre, si gjatë fushatës ashtu edhe pas zgjedhjes së tyre. Deri në një masë të madhe, partitë përcaktojnë se kur dhe nëse gratë do të bëhen lojtarë në arenën politike, dhe në çfarë mase.

Prandaj është e rëndësishme, për vëzhgues të vlerësojnë nëse dhe sa

partitë politike promovojnë gratë në poste drejtuese, nëse ata zgjedhin dhe promovojnë gratë si kandidat, dhe nëse ata mundohen nga jashtë të tërheqin gratë votuese duke ju drejtuar çështjeve me interes të veçantë për gratë. Organizimi dhe regjistrimi i partive politike është zakonisht i rregulluar me ligj, por brenda kuadrit të gjerë ligjor, partitë shpesh kanë liri të gjerë të përcaktojnë strukturat dhe procedurat e tyre të brendshme. Madje edhe në demokracitë e përparuara, partitë politike ndryshojnë shumë në nivel, në të cilën ato zbatojnë parimet demokratike brenda partisë, për shembull, në atë se si kandidatët janë zgjedhur dhe si listat e kandidatëve të partisë janë hartuar. Në përgjithësi, sa më shumë që partia të ndjek parimet demokratike dhe praktikat transparente në procedurat e veta të brendshme, aq më shumë mundësi do të jenë në dispozicion për gratë që të dalin si kandidatë dhe që çështjet me interes të veçantë për gratë të dalin si çështje serioze të fushatës. Sa më transparente janë rregulloret e brendshme të partisë, aq

më shumë gjasa ka që ata mund të përdoren nga aktivistët që të kërkojnë barazi, promovimin e grave si kandidatë, dhe për të nxjerrë në pah çështjet me interes për gratë. Shumë shpesh, megjithatë, funksionimi i brendshëm i partisë ka mungesë të transparencës apo përgjegjësisë madje edhe në mesin e anëtarëve të saj. Për atë se sa kjo ndikon në kandidaturën e grave, ka disa trende të përgjithshme që ja vlen të përmenden.

Partitë që respektojnë ideologjitë shoqërore progresive shpesh kanë më shumë gjasa të promovojnë gratë, si pjesë e tendencës të përgjithshme për të mbështetur sektorët e shoqërisë që janë tradicionalisht jashtë strukturës së pushtetit, qofshin ato gra, pakica kombëtare, të paaftë, ose të tjerë:

- ▶ Sidomos në demokracitë e reja të themeluara, shumë parti janë organizuar rreth një personaliteti të vetëm të profilit të lartë. Në rrethana të tilla, nëse personaliteti kryesor nuk është grua, shpesh ka pak interes dhe vullnet për të krijuar vende për kandidatë alternativë, duke përfshirë gratë;
- ▶ Disa dëshmi sygjerojnë se gratë kanë më shumë gjasa që të nominohen në parti me procedurat të decentralizuara të nominimit se sa në partitë ku emërimet e kandidatit janë të kontrolluara nga qendra;
- ▶ Shpesh, partitë zëvendësojnë integrimin e plotë të grave në rrjedhat kryesore të organizimit të partisë me krijimin e një krahu të "grave". Përderisa strukturat e tilla partiake mund të jenë faktor i rëndësishëm

në përkrahjen dhe dialogun ndërpartiak, në disa raste ato mund të rezultojnë izolimin dhe marginalizimin e grave dhe rëndësinë e tyre brenda partisë.

B. Faktorët që mund të dëmtojnë qëllimet e mira

Qëllimi i promovimit të grave kandidatë të afta mund të pengohet nga praktikat e brendshme të partisë apo mungesat të cilat lejojnë shmangien e ligjeve apo rregullave të brendshme. MVZ duhet të jetë vigjilent ndaj disa prej këtyre praktikave.

- ▶ Në shtetet ku sistemi i kuotave është vendosur që t'ju garantojë grave të paraqiten në listat e kandidatëve, apo ku partitë kanë miratuar vullnetarisht kuotat, këto ligje apo rregulla mund të jenë dhënë të pakuptimtë nëse grave nuk ju është garantuar vendosja në pozitat fituese në listat;
- ▶ "Përfaqësimi" gjinor mund të rezultojë nga përpilimi i një liste të përzier të kandidatëve thjesht për të kënaqur kërkesat për dorëzimin e tyre ose të duket se kanë një listë të ekuilibruar, por pastaj të braktiset ajo nëpërmjet tërheqjes apo dorëheqjes të grave pas ditës së zgjedhjeve. Çdo shenjë e praktikave të tilla duhet të shqyrtohet me kujdes nga MVZ. Në veçanti, çdo tregues se kandidatët (dhe sidomos kandidatët femra) janë të detyruar të dorëzojnë letrat paraprakisht të nënshkruara të dorëheqjes përpara se të hyjnë në listë duhet të shkaktojnë shqetësim;

-
- ▶ Në shtetet me sisteme votimi preferenciale, partitë në disa raste mundën që të mos mbështesin në mënyrë të barabartë gratë kandidate në listat e tyre. Disa parti mundën me heshtje të inkurajojnë simpatizuesit që të votojnë votat e preferencës për burrat më poshtë në listë, ose ata nuk do të zbatojnë disiplinën e partisë ndaj kandidatëve që inkurajojnë votuesit të injorojnë rradhitjen zyrtare të listave të partisë;
 - ▶ Partitë mund të mos japin udhëzime, trajnim, mbështetje, apo financa adekuate të barabarta për kandidatët e tyre femra.

C. Platformat dhe përpjekjet për fitimin e votave të grave

Platformat e partive politike mund të sigurojnë një pasqyrim të angazhimit të tyre për gratë dhe çështjet me interes të veçantë për gratë. Llojet e çështjeve që mund të tregojnë angazhime të tilla

mund të përfshijnë pozitat e partisë për papunësinë e femrës apo punësimin me orar të shkurtuar, punëtorët e parregulluar në ekonominë “e zezë”, planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues, shërbimet sociale, dhunën ndaj grave, subvencionet familjare dhe kujdesin ditor për fëmijë. Kur shqyrtohet platforma e partisë, MVZ duhet të vlerësojë masën në të cilën ata theksojnë pozicionet apo deklaratat politike për çështjet të një rëndësie të veçantë për gratë. Vëzhguesit duhet të vlerësojnë gjithashtu se sa të rëndësishme e konsiderojnë partitë politike tërheqjen e votave të grave dhe nëse fushatat e tyre targetojnë edhe votuesit femra. Një sferë tjetër me interes është nëse partitë politike kërkojnë ose kanë mbështetjen ose miratimin e OJQ-ve të grave ose grupeve të avokimit. Nëse një parti gëzon një mbështetje të tillë mund të jetë një tregues i interesit dhe angazhimit të saj për të zhvilluar programe efektive që avancojnë prioritetet në lidhje me interesat e grave.

PIKA PËR SHOYRTIM: PARTITË DHE KANDIDATËT

ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E PARTISË

- Çfarë proporcioni i anëtarësimit të partisë janë gratë? Çfarë proporcioni i lidershit? A është ndonjëra nga anëtarët e partisë në parlament femër?
- Si është përcaktuar udhëheqësia e partisë? A ka rregulla të veçanta për adresimin e emërimit, ose kandidaturës të grave? Nëse është kështu, a thua këto janë rregulla formale, të shkruara?
- Si përcaktohet lista e kandidatëve të partisë? A ka rregulla të veçanta për adresimin e emërimit, ose kandidaturës të grave? Nëse është kështu, a thua këto janë rregulla formale, të shkruara?
- Sa femra janë në listën e kandidatëve dhe në të cilat vende?
- A ka partia krahun e grave? Nëse po, cilat janë funksionet e saj dhe /ose domethëniet?
- A thua kandidatët duhet të dorëzojnë një letër paraprakisht të nënshkruar të dorëheqjes para se të vendosen në listë?

STRATEGJITË E FUSHATËS

- Deri në ç'masë platforma e partisë adresohen çështjet me interes të veçantë për gratë?
- A ka partia ndonjë strategji për tërheqjen e votave të grave?
- A thua ka partia mbështetjen e organizatave të grave?
- Çfarë lloj përkrahje ju jep partia kandidatëve të saj femra? Mbështetje financiare? Kohë për transmetim? Trajnim mbi atë se si të bëjnë fushatë zgjedhore në mënyrë efektive? A thua paraqiten gratë në posterat të fushatës zgjedhore të partisë?

PROBLEMET GJATË PERIUdhËS PARA ZGJEDHJEVE

- A thua ndonjëra nga gratë kandidate të partisë ballafaqohen me kërcënime ose pengesa në përpjekjet e tyre gjatë fushatës? A thua ndryshojnë këta nga problemet që hasin burrat?
- A thua gratë kanë hasur në ndonjë problem tjetër gjatë fushatës?

5.



GRATË DHE MEDIUMET: ROLI I ANALISTIT TË MEDIUMEVE

Analist i medias të MVZ është përgjegjës për vlerësimin e sasisë dhe cilësisë të mbulimit prej medimeve për gratë kandidate, si edhe për nxjerrjen e konkluzioneve mbi natyrën e përgjithshme të medimeve për mbulimin e grave në politikë. Ndër çështjet tjera që do të konsiderohen si pjesë e detyrave normale të analistit të medimeve është se deri në cilën masë medimet drejtojnë mbulimin politik për çështjet e grave të cilat janë me rëndësi të veçantë për gratë. Gjithashtu me interes është edhe shkalla në të cilin përpjekjet për edukimin e votuesve janë drejtuar ndaj grave dhe nëse llojet e mbulimit kushtuar grave apo përdorimi i stereotipeve mund të jenë pengesa për përparimin e grave në procesin politik.

A. Medimet dhe ndikimi i tyre në qëndrimet publike

Zotimet e OSBE-së për zgjedhje demokratike kërkojnë që asnjë pengesë ligjore ose administrative mos të qën-

drojë në rrugën e qasjes të papenguar deri te medimet në baza jo-diskriminuese për të gjitha grupimet politike dhe individët të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor. MVZ duhet të vlerësojë nëse gratë kandidate përballen me ndonjë diskriminim në qasjen e tyre deri te medimet.

Përtej çështjes së qasjes së barabartë, sasia dhe cilësia aktuale e mbulimit prej medimeve për gratë kandidate ka një ndikim të rëndësishëm në imazhin e tyre publik dhe perspektivat e tyre zgjedhore. Roli kryesor i medimeve në çdo zgjedhje është të sigurojë që publiku të ketë njohuri të mjaftueshme për kandidatët dhe partitë që të jetë në gjendje të bëjë zgjedhje të informuar. Këta faktorë theksojnë nevojën për të vlerësuar nëse gratë kandidate kanë pjesë korrekte dhe të paanshme të mbulimit të fushatës prej medimeve. MVZ prandaj duhet të shqyrtojë çështjet e tilla se a thua medimet promovojnë vizibilitetin e grave kandidate, a thua ata kultivojnë pranimin publik të grave si një karakteristikë normale e jetës

politike, dhe a thua ata paraqesin gratë në mënyrë që promovon besimin e publikut në cilësitë e tyre si udhëheqës politik. Mënyra në të cilën mediumet i paraqesin gratë shpesh mund të jetë një tregues i rëndësishëm i statusit të gruas në shoqëri në përgjithësi.

çështje të tilla si arsimi apo kujdesi për fëmijët;

- ▶ Rëndësia e të ashtuquajturave çështjet e grave mund të zhvleftësohen në qoftë se, për shembull, ata janë të mbuluara në kolumnat e grave në vend se në lajmet e përgjithshme.

B. Çështjet e përgjithshme për tu ndjekur

MVZ duhet të jetë vigjilent në treguesit e mëposhtëm të trajtimit të grave nga mediumet:

- ▶ Kandidatët femra shpesh herë fitojnë më pak mbulim total se sa homologët e tyre meshkuj, si dhe mbulim më pak të rëndësishëm. Kandidatët femra mund të përdoren më rrallë si burime të informimit dhe opinionit ose ka më pak gjasa që të paraqiten si mysafirë në programet politike;
- ▶ Kandidatët femrat mund të fitojnë më pak mbulim të qëndrimeve të politike mbi çështjet dhe më shumë për karakteristikat e tyre personale dhe pamjen se sa homologët e tyre meshkuj;
- ▶ Si kandidatë, gratë mund të portretizohen shpesh në rolin e tyre tradicional si bashkëshorte dhe nëna. Imazhe të tilla mund të imponohen nga mediumet ose mund të jenë nxitur nga reklamato politike të kontrolluara nga partitë apo vetë kandidatët. Për shembull, shpesh herë gratë kandidate mund të përdorin statusin e tyre si nënë dhe kujdestare për të justifikuar qëndrimet e tyre mbi

C. Teknikat për monitorimin e medimeve gjatë fushatave zgjedhore

Kur një MVZ ka një ekip të plotë për monitorimin e medimeve për të analizuar lajmet e transmetuara dhe të shtypura, programet politike, reklamato politike, dhe përmbajtjet e komenteve të redaktorit në bazë të orarit të plotë, mund të ketë mundësi për të zgjeruar kriteret e vlerësimit për të identifikuar trendet në lidhje me mbulimin e grave dhe portretizimin e tyre. Në mënyrë tipike, një përpjekje e plotë e monitorimit të medimeve përfshin një vlerësim të sasisë krahasuese të kohës apo hapësirës së ofruar për partitë apo kandidatët e ndryshëm dhe për atë nëse toni në ndonjë artikull të veçantë ose transmetim është pozitiv apo negativ. Në mënyrë që të vlerësojnë trajtimin e grave kandidate në krahasim me homologët e tyre meshkuj, do të ishte e dobishme që të lidhen këto rezultate edhe me gjininë. Nëse kjo nuk është praktike, ose në qoftë se nuk është në dispozicion një ekip i plotë për monitorimin e medimeve, edhe më tutje mund të jetë e mundur brenda kufizimeve kohore dhe personelit të kryhet një analizë në vendin e

ndodhisë - edhe nëqoftë se statistikisht nuk është e rëndësishme – të mundësojë një pasqyrë të ndryshimeve që mund të ekzistojnë në mënyrën që janë të mbuluar kandidatët burra dhe gra. Dy metoda, jo domosdoshmërisht përjashtuese ndaj njëra-tjetrës, mund të vihen në funksion:

- ▶ Anëtarë të personelit lokal mund të caktohen për të ndjekur transmetimet e veçanta në stacionet televizive kryesore në kohën e përcaktuar nga analisti i medimeve. Secilit anëtar të personelit mund ti caktohet një lajm i veçantë apo program politik në mënyrë që askush nuk do të mbingarkohet;
- ▶ Personeli lokal mund të ndërmarrë një studim në thellësi të botimeve të shumta në një ditë të vetme në ndonjë moment të caktuar para ditës së zgjedhjeve.

Gjithsesi, personeli mund të analizojë dhe regjistrojë rezultatet e tyre lidhur me:

- ▶ Numrin e artikujve apo sasinë e kohës të përkushtuar për burrat dhe gratë kandidate;
- ▶ Pjesën e hapësirës në shtyp ose kohën e transmetimit të kushtuar karakteristikave personale ose pamjes përballë informatave në lidhje me çështjet ose aktivitetet politike të burrave dhe grave;
- ▶ Rastet në të cilat gratë janë portretizuar në mënyrë që përshkruan rolin e tyre tradicional si bashkëshorte dhe nëna;
- ▶ Rastet ku gjuha, etiketat, ose elementet vizuale përdoren me qëllim të zvogëlimit të reputacionin ose trivializimit të arritjeve të grave;
- ▶ Numrin e artikujve që përqendrohen në çështjet me interes të veçantë për gratë, dhe nëse ata janë artikuj apo lajme që adresohen në seksionin që ka në shënjestër gratë.

MBULIMI I GRAVE DHE ÇËSHTJEVE TË GRAVE

- Si do ta karakterizonit trajtimin e përgjithshëm të grave në mediimet masive?
- Si kompetent dhe të aftë dhe profesional?
- Nga imazhet tradicionale stereotipike si bashkëshorte dhe nëna?
- Raportim i sensacionalizuar?
- Ku mediati e shkruara zakonisht vendosin artikujt rreth çështjeve me interes të veçantë për gratë? Në lajmet e përgjithshme? Në kolumnet ose çështjet e grave? Faqen ballore?
- A përdorin mediimet rregullisht gjuhë seksiste apo etiketa për gratë dhe në veçanti gratë udhëheqëse?
- Çfarë proporcioni i lajmëruesve të lajmeve televizive ose nikoqire të programeve politike janë femra? Çfarë përqindje të redaktorëve apo kolumnistëve politik janë femra?

MBULIMI I GRUAS DHE ZGJEDHJET

- A kanë qasje të barabartë në mediimet gratë kandidate mbi një bazë jo-diskriminuese?
- A thua gratë kandidate fitojnë sasi dhe cilësi të krahasueshme të mbulimit me atë të burrave? Nëse jo, sa mbulim pranojnë burrat dhe gratë në krahasim me numrin e kandidatëve të secilës gjini?
- A thua dallimet në sasinë e mbulimit rezultojnë nga zgjedhja e medimeve ose nga zgjedhja e partive politike?
- A ekziston ndonjë reklamë politike e drejtuar veçanërisht për gratë votuese?
- A ekziston ndonjë përpjekje për edukimin e votuesve ose për daljen për të vuajtur që janë targetuar në veçanti për gratë?

6.



VAGJ DHE VASH: ROLI I KOORDINATORIT TË VAGJ

Koordinatori i MVZ për vëzhguesit afatgjatë (VAGJ) është përgjegjës për të siguruar që VAGJ janë të vetëdijshëm për përparësitë e MVZ-së në lidhje me gratë dhe zgjedhje dhe se ata raportojnë informatat nga terreni të cilat mund të jenë të dobishëm në realizimin e vlerësimeve dhe nxjerrjen e konkluzioneve mbi këto çështje. Koordinatori i VAGJ duhet të punojnë ngushtë me analistët gjinor ose pikën fokale gjinore për të përcaktuar sa më mirë detyrat specifike për VAGJ. Koordinatori i VAGJ gjithashtu do të ndihmojë në vendosjen e prioriteteve për vëzhguesit afat shkurtër (VASH) në lidhje me raportimin mbi aktivitetet e grave në ditën e zgjedhjeve.

A. Vëzhguesit afatgjatë (VAGJ)

Vëzhgues afatgjatë luajnë një rol kryesor në sigurimin që një MVZ ka një qëllim në mbarë vendin në mbledhjen e informatave mbi ngjarjet politike dhe trendet në rajonet dhe në identifikimin e veçorive rajonale që mund të kenë

ndonjë ndikim mbi zgjedhjet. Si të tilla, ata janë në pozitë kryesore për të kontribuar në analizën e MVZ-së mbi rolin e grave në procesin zgjedhor. Me qëllim që të kontribuojnë në mënyrë efektive, ato duhet të informohen për qasjen e përgjithshme të ODIHR-it ndaj çështjeve gjinore dhe zgjedhjeve dhe duhet të kenë një kuptim bazë të zotimeve të OSBE-së dhe zotimeve tjera ndërkombëtare mbi të drejtat njerëzore të grave, veçanërisht të drejtat e tyre zgjedhore. Të dhënat në Kapitullin 1 mundësojnë informata themelore që duhet të jenë të dobishme për të VAGJ si edhe për anëtarët e ekipit thelbësor të MVZ-së. Në rrjedhën e punës së tyre të rregullt, VAGJ duhet të jenë në gjendje të grumbullojnë një sërë informatash të dobishme për rolin e grave në procesin zgjedhor në rajonet e tyre. Këto informata duhet të përfshihen në raportimin e rregullt të VAGJ në selinë e MVZ. Në dritën e ngarkesës së tepërt të punës të rëndë me të cilën VAGJ shpesh ballafaqohen, shkalla në të cilën ata mund të përqendrohen në çështjet gjinore mund të ndryshojë

shumë. Për shkak të kësaj, ekipi kryesor duhet të paralajmërojë ata për çështjet apo problemet e veçanta që mund të meritojnë vëmendje ose ndjekje të veçantë.

B. Vëzhguesit afatshkurtër (VASH)

Vëzhgues afat shkurtër duhet gjithashtu të përfshihen në monitorimin e pjesëmarrjes së grave në ditën e zgjedhjeve. Raportimi i formave të përdorura nga VASH pasi që ata vëzhgojnë aktivitetin e votimit në vendvotimet duhet të përfshijnë pyetjet që i shërbejnë këtij qëllimi, në mënyrë që të dhënat të mund të kuantifikohen gjatë analizave të formave.

- ▶ VASH duhet të drejtohen të përcaktojnë numrin e burrave dhe grave në çdo këshill zgjedhor dhe gjininë e çdo kryetari të këshillit;
- ▶ VASH mund gjithashtu të drejtohen të përcaktojnë përqindjen e grave që shërbejnë si vëzhgues të partive politike dhe/ ose vëzhguesve jopartiak vendor;
- ▶ Për aq sa është e mundur, VASH duhet gjithashtu të kërkojnë nga kryetari i këshillit zgjedhor të vlerësojë se sa gra dhe sa burra kanë votuar në të vërtetë apo, nëse është e nevojshme, të japin një mendim subjektiv të bazuar mbi vëzhgimet e tyre;

- ▶ Forma e raportimit duhet të lejojë raportimin e incidenteve të "votimit familjar", ku dy ose më shumë persona hyjnë në të njëjtën kabinë të votimit për të votuar së bashku. Zakonisht, votimi familjar përfshin burrat dhe gratë. Votimi familjar është një shkelje e zotimeve të OSBE-së për fshehtësinë e votimit të secilit personi dhe mund të jetë disavantazh në veçanti për gratë, veçanërisht në shoqëritë tradicionale patriarkale, ku gratë nuk mund të kenë liri të mjaftueshme për të bërë zgjedhje të pavarur. Një frekuencë e lartë e votimit familjar mund të sugjerojë se gratë nuk kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në zgjedhje;
- ▶ Incidentet e votimit në emër të dikujt tjetër - në të cilat një person paraqet dokumentet për disa njerëz dhe voton në emër të atyre të gjithëve - duhet gjithashtu të raportohet. Votimi në emër të dikujt tjetër nuk është e lejuar në shumicën e vendeve pasi që ai komprometon fshehtësinë e votimit dhe nuk është në përputhje me zotimet e OSBE-së. Votimi në emër të dikujt tjetër mund të jetë më i shpeshtë në zonat rurale dhe në mesin e grupeve të caktuara të pakicave dhe mund të jetë disavantazh i veçantë për gratë. VASH duhet të vlerësojnë se si këshillat zgjedhore marren me secilën përpjekje për votim në emër të dikujt tjetër.

VAGJ DHE VASH: ROLI I KOORDINATORIT TË VAGJ LISTA KONTROLLUESE PËR VAGJ DHE VASH

VAGJ

- A thua ka gra që kandidojnë si kandidatë në rajonin tuaj? Nëse po, çfarë përqindje e kandidatëve janë femra? A është ky numër më i madh ose më i vogël se sa në zgjedhjet e mëparshme?
- A ka ndonjë parti dukshëm më tepër gra kandidatë se të tjerët? A thua ndonjë parti bën përpjekje të veçantë për të tërhequr gratë votuese apo për t'ju adresuar çështjeve me interes të veçantë për gratë?
- A ka tanimë gra të zgjedhura si udhëheqës në zonën tuaj të detyrës? Në çfarë raport?
- A thua ka gra anëtare të komisioneve zgjedhore rajonale dhe lokale? Në çfarë raporti? Sa këshilla zgjedhore të tilla janë të kryesuara nga femrat?
- Në zonën tuaj të detyrës, a thua janë të regjistruara gratë si votues në numër të njëjtë si burrat? Nëse jo, a thua mund të identifikoni pse jo?
- A ekziston ndonjë fushatë për edukimin e votuesve dhe për daljen në votim të drejtuara për gratë?
- Nëse ka numër të konsiderueshëm të njerëzve që u përkasin minoriteteve në zonën tuaj të detyrës, a thua gratë në mesin e tyre marrin pjesë në zgjedhjet në mënyrë aktive si burrat, ose a thua ka ndonjë faktor që kufizon pjesëmarrjen e tyre?
- A ka ndonjë çështje tjetër në zonën tuaj të detyrës që duket se ndikon në pjesëmarrjen e grave si votues dhe/ose si kandidatë, qoftë pozitivisht apo negativisht?

VASH

- Sa burra dhe gra janë anëtarë të secilit këshill zgjedhor? A është kryetari i këshillit grua apo burrë?
- Sa burra dhe gra kanë votuar në vendvotimet tuaja? Nëse zyrtarët e zgjedhjeve në vendvotim nuk mund t'ju japin këto shifra, a keni vënë re në vëzhgimet tuaja nëse gratë duket se kanë votuar në numër të njëjtë si burrat?
- A ka pasur raste të votimit familjar?
- A ka pasur raste të votimit në emër të dikujt tjetër?
- Në vërejtjet tuaja dhe/apo bisedat me anëtarët e këshillit zgjedhor të vendvotimit, përfaqësuesit e partive, dhe votuesit, a keni vërejtur ndonjë gjë që mund të sugjerojë se gratë votues nuk marrin pjesë në të njëjtën mënyrë si burrat?
- Sa është përqindja e përgjithshme e grave që shërbejnë si vëzhgues vendas, si përfaqësues të partive politike/kandidatëve dhe vëzhguesve jopartiak nga vendi?

7.



ANALIZA ME MË SHUMË DETAJE DHE INFORMATA: ROLI I ANALISTIT GJINOR

Kurdo që të jetë e mundur ose e përcaktuar si e nevojshme, ODIHR-i do të emërojë një analist gjinorë me orar të plotë si pjesë e ekipit bazë të Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Analisti gjinor është përgjegjës për fushën e gjerë të punës të MVZ-së për çështje gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në zgjedhje. Analisti gjinor duhet të ofrojë udhëzime për të gjithë anëtarët e ekipit bazë dhe vëzhguesit afatgjatë, të sigurojë se çështjet gjinore janë të integruara në punën e MVZ, koordinojnë punën në ekip mbi çështjet gjinore, dhe marrin rolin udhëheqës në raportimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve mbi çështjet e zgjedhjeve që lidhen me gjininë. Nënseksioni më poshtë përmbledh një shumëllojshmëri çështjesh të rëndësishme që mund të eksploroehen në thellësi më të madhe nga analistët gjinor. Në mungesë të analistgjitor me orar të plotë, kreu i misionit duhet të caktojë një anëtar të grupit thelbësor për të shërbyer si pikë fokale gjinore si plotësim i detyrave normale të tij ose të saj. Pasi që pika fokale ka edhe përgjegjësi tjera

me orar të plotë, roli i tij/i saj do të jetë kryesisht për koordinim. Analisti gjinor ose pika fokale normalisht duhet të ndihmohet nga një asistent prej personelit lokal i punësuar me orar të plotë i cili do të jetë i dedikuar për grumbullimin e informatave, përkthimin dhe analizimin e pjesëmarrjes së grave. Nën drejtimin e analist ose pikës fokale gjinore, asistenti lokal mundet gjithashtu të sigurojë mbështetje për anëtarët e tjerë të ekipit thelbësor në monitorimin e çështjeve gjinore në sferat e tyre përkatëse.

A. Gratë në shoqëri

Mundësia e grave për të fituar përparësi të plotë të të drejtave të tyre njerëzore dhe për të marrë pjesë plotësisht në jetën politike - duke përfshirë procesin zgjedhor - varet nga ambienti shoqëror në shtet. Një analizë e vendit të gruas në shoqëri në përgjithësi dhe ndonjë pengesë për avancimin e grave mund të sigurojë një bazë të vlefshme për një kuptim më të mirë për rolin e grave në procesin

zgjedor. Në shoqëritë në të cilat gratë në përgjithësi janë të pabarabarta - në të drejtat ligjore, ekonomi, arsim, apo sfera të tjera – ka më shumë gjasa që gratë të jenë në pozitë të pafavorshme gjithashtu lidhur me të drejtat zgjedhore dhe pjesëmarrjen politike.

Për të vlerësuar se a thua “fusha për lojën” zgjedhore është e barabartë edhe për gratë dhe burrat, mund të jetë e dobishme për MVZ të shikojë kushtet e përgjithshme shoqërore. Pyetjet e shënuara më poshtë mund të përdoren për të ndihmuar vlerësimin nëse ndonjë shtet përmbush standardet ndërkombëtare mbi të drejtat njerëzore të grave të pranuar nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe të përfshira në CEDAW.

- ▶ A thua janë gratë dhe burrat të barabartë përpara ligjit? A thua ekziston diskriminimi ligjor kundër grave? Diskriminim *de facto*? A kanë gratë të njëjtat të drejta si burrat në lidhje me martesën dhe brenda familjes?
- ▶ A thua gratë kanë të njëjtën qasje për arsim si burrat?
- ▶ A thua gratë kanë të njëjtën qasje në punësim si burrat? A është shkalla e papunësisë më e lartë në mesin e grave? A thua janë pagat më të ulëta midis grave? A kanë gratë qasje të barabartë deri te huazimet dhe kreditë bankare?
- ▶ A thua gratë kanë të drejta të barabarta për kujdesin shëndetësor?
- ▶ A është dhuna ndaj grave problem i vazhdueshëm në shoqëri?

- ▶ A ka kuptuar dhe përqaftuar shoqëria në përgjithësi konceptin e barazisë mes grave dhe burrave dhe respektimin e të drejtave njerëzore të grave?
- ▶ A ka ndonjë ndarje të veçantë urbane/ rurale në qëndrimet në drejtim të barazisë midis grave dhe burrave?

B. Gratë në politikë

Kapitulli 1 jep një listë themelore të të dhënave statistikore që një MVZ duhet të përpiqet ti ketë për të ndihmuar vlerësimin e nivelit të pjesëmarrjes politike të grave. Misionet me një analist gjinor me orar të plotë pune duhet të jenë në gjendje të gërmojnë më thellë në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të tilla dhe vendosjen e tyre në një perspektivë më kuptimplotë. Për shembull, MVZ duhet të kërkojë raportin e burrave dhe grave në parlament që po përfundojnë mandatin. Megjithatë, kur Misionet mund tu kushtojnë më shumë resurse çështjes gjinore, mund të jetë gjithashtu e dobishme për të patur statistika krahasuese mbi numrin e burrave dhe grave që mbajnë mandatet dhe të cilët po kandidohen për ri-zgjedhje dhe numrin a tyre të cilën kanë vendosur të mos kandidohen përsëri. Në disa shtete, dëshmitë sugjerojnë se gratë kanë më shumë gjasa të largohen nga politika, se sa burrat. Si arsye për këtë, gratë në poste publike kanë përmendur shumë shqetësime, duke përfshirë edhe vështirësitë e balancimit të kërkesave profesionale dhe të jetës familjare, ndjenja se ata nuk kuptohen seriozisht,

pakënaqësia me atmosferë konfrontuese në shumë parlamente, ose një ndjenjë se ata nuk mund të përparojnë në mënyrë të mjaftueshme për shkak të fuqisë së rrjeteve të shoqërive të “burrave të vjetër”. Marrja e shënimeve për mbajtësit e mandateve të cilët nuk dëshirojnë të kandidohen përsëri mund të përcaktojë se a thua ekziston një model i grave që largohen nga detyra në numër dis-proporcional. Intervistat me mbajtësit e mandateve të përfshirë mund të japin spjegimin për rrethanat që kanë ndikuar në vendimet e tyre të mos kërkojnë të rizgjidhen.

Është gjithashtu e rekomanduar që MVZ të ndjek numrin e kandidatëve të mundshëm të refuzuar nga autoritetet përgjegjëse për regjistrimin e kandidatit. Në veçanti, një krahasim duhet të bëhet për të përcaktuar nëse ekziston një përqindje jo e barabartë e numrit të përgjithshëm të kandidatëve të refuzuar femra në krahasim me kandidatët meshkuj të refuzuar. Në rast të tillë një pabarazi është vurë në dukje se MVZ mund të dëshirojnë të hetojë për të përcaktuar arsyet për pabarazinë.

Një analizë më në thellësi të numrit të burrave dhe grave në regjistrin e votuesve mund të sigurojë gjithashtu njohuri të vlefshme për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje. Përtej statistikave kombëtare, MVZ gjithashtu mund të kërkojë informata për atë se a thua ka dallime të rëndësishme në pjesëmarrjen e grave në disa rajone, ose në mesin e disa grupeve të pakicës dhe, nëse po, pse. Në qoftë se ka shumë persona të zhvendosur në shtet, ia vlen të shqyrtohet se a thua gratë e zhvendosura janë të regjistruara për

të votuar dhe për të marrë pjesë në zgjedhje në të njëjtën bazë si burrat.

Një kuptim më i mirë i pjesëmarrjes së grave në procesin politik mund të jetë zhvilluar nëpërmjet mbledhjes së informatave për gratë në këshillat lokale dhe rajonale ose kuvendet. Në veçanti, ajo është e dobishme për të mësuar se sa këshilla lokale dhe rajonale ose kuvende janë të kryesuar nga gratë. Një rrugë e përbashkët për zyrat e zgjedhura në nivel kombëtar është shpesh nëpërmjet të suksesit politike në nivel lokal. Nëse femrat nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në organet vendore, baza e grave kandidate të kualifikuara dhe me përvojë për zyrat kombëtare është e zvogëluar.

Një tjetër barometër i pjesëmarrjes së grave dhe suksesit politik është numri i ministrive të qeverisë dhe funksionet e ngjashme të mbajtura nga gratë. Nëse MVZ qëndron në shtet deri sa të formohet kabineti i ri, krahasimi i numrit të grave në qeverinë e re dhe në atë që po largohet, mund të ilustronjë një trend. Një përmbledhje e posteve të kabinetit mundet gjithashtu të ndërmerret për të përcaktuar se cilat ministri i udhëheqin gratë. Edhe pse ka përjashtime, gratë janë më shpesh të caktuara në ministrinë gjegjëse për shërbimet sociale që kanë të bëjnë me atë që konsiderohen zakonisht çështje e grave. Kritikët sugjerojnë se kjo praktikë është një reflektim i pritjeve shoqërore bazuar në rolet stereotipike të grave si nëna dhe amvise dhe qëndrimet për atë se cilat funksione janë të përshtatshme për gratë dhe cilat nuk janë. Në një numër shtetesh, janë formuar partitë politike “të grave”. Këto mund të jenë një burim i

informatave në lidhje me gratë në procesin zgjedhor, si edhe me çështjet me interes të veçantë për gratë. Përderisa degët e partive politike të grave janë gjithashtu në pozitë të sigurojnë njohuri të dobishme në çështjet që kanë të bëjnë me gratë, në praktikë ata kanë më tepër gjasa që të pasqyrojnë vijën partiake.

Një tjetër faktor tregues është se si femrat trajtohen në kuadër të sistemit ligjor, veçanërisht në lidhje me çështjet zgjedhore. Përtej të drejtave të tyre *de iure*, a thua gjykatat janë të kapshme për gratë, dhe a thua femrat paditëse trajtohen në mënyrë të barabartë me burrat? Nëse femrat kandidatë ose zyrtarë të partive politike janë përfshirë në ankesat apo raste të tjera gjyqësore lidhur me zgjedhjet, MVZ duhet të ndjekë me kujdes çështjet zgjedhore të përfshira dhe të bëjë një vlerësim nëse rasti trajtohet ndryshe nga rastet e ngjashme që përfshin burrat.

Kapitulli 5 ofron udhëzime themelore për gjininë dhe medimeve gjatë zgjedhjeve. Një MVZ me një analist gjinor mund të jetë në gjendje të ndërmarrë një analizë të gjerë për atë se si trajtimi i grave prej medimeve ndikon në pjesëmarrjen dhe perspektivat e tyre zgjedhore. Për shembull, aq sa lejojnë burimet, analizat e medimeve do të plotësohen nëse kriteret shtesë krahasuese mund të shtohen për atë si medimet i trajtojnë meshkujt dhe femrat përkatësisht. Kriteret e tilla mund të përfshijnë nëse përmbajtja e një artikulli ose transmetimi përqendrohet në një kandidat të vetëm kryesisht japin informata rreth personalitetit të tyre, statusit familjar, ose karakteristikat

personale dhe jo qëndrimet e tyre mbi çështjet politike; dhe nëse përmbajtja përfshin përmendjen e çështjeve që lidhen me gratë në mënyrë tipike, të tilla siç janë kujdesi shëndetësor, përkujdesi për fëmijër, mirëqenia sociale, apo arsimi, pavarësisht nëse artikulli ose transmetimi ka të bëjë me kandidatin apo partinë politike.

C. Burimet zyrtare të informimit

Disa institucione shtetërore mund të jenë burime të rëndësishme për zhvillimin e një profil të pandarë gjinor të shtetit që është duke u vëzhguar:

- ▶ Organet zgjedhore në nivel qendror dhe rajonal në mënyrë të veçantë do të jenë burimet kryesore të informatave për numrin krahasues të kandidatëve meshkuj dhe femra, anëtarë të komisioneve zgjedhore dhe këshivae zgjedhore të vendvotimeve, dhe kryetarëve të atyre organeve zgjedhore;
- ▶ Zyrat e vetëqeverisjes lokale apo zyrat lokale të Ministrisë së Brendshme (policia lokale) janë burimet më të mundshëm të informatave në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe shifrat e dhëna krahasuese në lidhje me numrin e burrave dhe grave të regjistruar në rajonet e tyre;
- ▶ MVZ gjithashtu duhet të përcaktojë se cilat ministri, departamente, ose komisione janë në mënyrë specifike të ngarkuar me përgjegjësinë për zbatimin e të drejtave të barabarta, kundër diskriminimit, ose dispozitat e barazisë gjinore. Gjithashtu, duhet

të merren parasysh në qoftë se nuk ka agjenci të tillë. Shpesh, agjencia nuk është një organ i pavarur, por është në varësi të ndonjë ministrie ekzistuese, për shembull, ministrisë së punës dhe punësimit, apo të familjes dhe mirëqenies sociale. Këto agjenci duhet të jenë në gjendje të japin informata dhe njohuri të rëndësishme për politikën dhe vështirësitë që ndeshen në promovimin dhe zbatimin e barazisë gjinore;

- ▶ Në pothuaj të gjitha shtetet, ka një departament ose institut statistikor që përpilon të dhëna mbi një mori të subjekteve, duke përfshirë informatat bazë për regjistrimin e popullatës, të dhënat ekonomike, statistikë dhe arsimit dhe shëndetësisë, mirëqenies sociale, etj. Në mënyrë ideale, informatat do të jenë në dispozicion në format që lejon të bëhen krahasime midis burrave dhe grave për çështje të tilla siç janë shkrimi dhe leximi, arsimit, punësimit, apo të ardhurat;
- ▶ Zyra e Avokatit të Popullit ose zyra kombëtare për të drejtat e njeriut mund të jetë një burim i rëndësishëm i informatave për problemet e veçanta me të cilat ballafaqohen femrat;
- ▶ Takimet me gjykatësit dhe prokurorët, si dhe shoqatat profesionale të avokatëve dhe organizatat për lobim të grave, mund të japin njohuri si sistemi ligjor i trajton gratë.

D. Organizatat joqeveritare

Një detyrë thelbësore për Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve është takimi me organizatat joqeveritare, shoqatat profesionale dhe grupet qytetare. Kontributi i tyre mund të jetë veçanërisht i dobishëm në konfirmimin ose kundërshtimin e përshtypjeve nga burimet zyrtare. Sa i përket çështjeve që lidhen me pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor, OJQ-të e veçanta mund të jenë në veçanti të kualifikuara për të diskutuar pengesat në pjesëmarrjen e grave, nivelin e reagimit të institucioneve shtetërore për nevojat e grave, dhe nivelin e zotimit për çështjet e grave në pjesën e kandidatëve dhe zyrtarëve të zgjedhur. Përtej mbledhjes së informatave të përgjithshme, niveli i angazhimit të grave në politikë përmes pjesëmarrjes së tyre në punën e organizatave joqeveritare është në vetvete një masë për pjesëmarrjen politike të grave në shoqëri. Përfshirja e tillë mund të jetë një forcë e fuqishme për ndryshime shoqërore. Vlerësimi i statusit të OJQ-ve të grave, pranimi i tyre si pjesë integrale e shoqërisë civile, dhe aftësia e tyre në promovimin e vetëdijes për çështjet, dhe aftësia e tyre për të ndikuar në ndryshimet shoqërore dhe politike mund të sigurojë një dimension të rëndësishëm shtesë për respektimin e pjesëmarrjes së grave në procesin politik.

PIKA PËR SHOYRTIM: ANALIZA MË TE HOLLËSISHME DHE INFORMACIONET

GRATË NË SHOQËRI

- Deri në çfarë mase shteti i përmbush zotimet e tij ndaj OSBE-së dhe zotimet tjera ndërkombëtare mbi të drejtat njerëzore të grave dhe barazinë e grave dhe burrave?
- A thua janë femrat të barabarta para ligjit? Si ata trajtohen nga sistemi gjyqësor, veçanërisht në lidhje me çështjet zgjedhore?
- A ka ndonjë dëshmi të diskriminimit kundër gruas në shoqëri?
- A kanë gratë qasje të barabartë në arsim, kujdes shëndetësor, dhe punësim?
- A thua gratë gëzojnë barazi në fushën ekonomike?
- A venë gratë në dispozicion përdorimin e institucioneve kombëtare siç janë avokati i popullit apo komisionet për të drejtat e njeriut? Nëse po, çfarë lloj të ankesave ata parashtrojnë?

GRATË NË POLITIKË

- A e lëshojnë gratë politikën në numër më të madh se burrat? Nëse po, pse? Sa mbajtës të mandateve meshkuj dhe sa femra kanë zgjedhur mos të kandidohen?
- A ka regjistrimi i kandidatëve femra më shumë gjasa të jetë i refuzuar se ai i meshkujve?
- A thua listat e votuesve shfaqin ndonjë pabarazi midis femrave dhe meshkujve?
- A janë gratë të përfaqësuara mirë në këshillat lokale dhe kuvendet rajonale?
- A luajnë gratë rol të rëndësishëm si ministra të qeverisë ose kryetare të bashkive?
- A ekzistojnë parti politike “të grave”, dhe athua kanë ndonjë ndikim të rëndësishëm? Çfarë çështje ata konsiderojnë si më të rëndësishmet?
- A thua degët e partive politike të femrave kanë prioritet të ndryshme nga ato të strukturës qendrore të partisë?

ORGANIZATAT JOQEVERITARE

- A ka OJQ të cila fokusohet në avancimin e të drejtave të grave? Çfarë konsiderojnë ata si çështje me interes të veçantë?
- A ka ndonjë OJQ që është e përfshirë në mënyrë specifike në përpjekjen për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë? Nëse po, çfarë njohuri mund të ofrojnë ata për pengesat ose barrierat për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje?
- Deri në çfarë mase gratë marrin pjesë në punën e OJQ-ve? Deri në çfarë mase gratë marrin pjesë në punën e OJQ-ve të përfshira në çështjet zgjedhore?
- A janë të përfshira gratë në pozita udhëheqëse në OJQ-të? Nëse po, a thu kjo ka qenë një formë efektive e pjesëmarrjes politike dhe realizimin e asaj që të dëgjohet zëri i tyre?

SHTOJCA: STANDARDET E ZGJEDHURA NDËRKOMBËTARE

Zotimet e zgjedhura të OSBE-së

Karta Evropiane e Sigurimit, Stamboll, 1999

23. Ushtrimin i plotë dhe i barabartë i të drejtave të njeriut nga ana e grave është thelbësore për të arritur një mjedis më të qetë, të begatë dhe demokratik të OSBE-së. Ne jemi të angazhuar për ta bërë barazinë midis burrave dhe grave pjesë integrale të politikave tona...

24. Ne do të ndërmarrim masa për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave dhe për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave ...

Dokumenti i Moskës, 1991

40. Shtetet pjesëmarrëse të njohin se barazia e plotë dhe e vërtetë midis burrave dhe grave është një aspekt themelor i një shoqërie të drejtë dhe demokratike e bazuar në sundimin e ligjit. Ata e kuptojnë se zhvillimi i plotë i shoqërisë dhe mirëqenies së të gjithë anëtarëve të tij të kërkojë mundësi të barabarta për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të burrave dhe grave. Në këtë kontekst ata do të:

40,1 - sigurojnë që të gjitha angazhimet e KSBE kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të zbatoh-

en plotësisht dhe pa diskriminim në lidhje me gjininë;

40,2 - në përputhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW), nëse ata janë palë; ...

40,3 - pohojnë se kjo është qëllimi i tyre për të arritur jo vetëm de jure por de facto barazinë e mundësive midis burrit dhe gruas dhe për të nxitur masat efikase për këtë qëllim; ...

40,8 - inkurajojnë dhe nxisin mundësi të barabarta për pjesëmarrje të plotë të femrave në të gjitha aspektet e jetës politike dhe publike, në proceset vendim-marrëse dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar në përgjithësi; ...

40,13 - të sigurojnë mbledhjen dhe analizën e të dhënave për të vlerësuar në mënyrë adekuate, të monitoruar dhe për të përmirësuar gjendjen e grave ...

Standardet dhe detyrat e zgjedhura të kombeve të bashkuara

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 2. Gjithkush ka të drejtë për të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa dallim të çfarëdo

lloji, të tilla si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, besimi, opinioni politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes apo statusit tjetër ...

Neni 7. Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë nga ligji ...

Neni 21. 1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

2. Gjithkush ka të drejtën e qasjes së barabartë në shërbimet publike në vendin e tij.

3. Vullneti i popullit do të jetë autoriteti i qeverisë, ky do të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat do të bëhen me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe do të mbahen me votim të fshehtë ose sipas procedurës ekuivalente të votimit të lirë ...

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 3. Shtetet pale në këtë Pakt angazhohen të sigurojnë të drejta të barabarta të burrave dhe grave në gëzimin e të gjitha të drejtave civile dhe politike të parashtruara në Pakt.

Neni 25. Çdo qytetar do të ketë të drejtë dhe mundësi ...

(a) Të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike, drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;

(b) Për të votuar dhe për t'u zgjedhur në zgjedhje periodike të vërteta e cila do të bëhet me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe do të mbahen me votim të fshehtë, që garantojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve ...

Neni 26. Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë nga ligji ...

Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave

Neni 2. Shtetet Pale dënojnë rëndë diskriminimin ndaj në të gjitha formave të saj, pajtohen që të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politike të eliminimit të diskriminimit dhe të rënda ndaj, për këtë qëllim, të ndërmarrë:

(a) të materializoj parimin e barazisë së burrave dhe grave në kushtetutet e tyre kombëtare ose legjisla-cion tjetër të përshtatshëm në qoftë se nuk janë përfshirë ende aty dhe për të siguruar, me ligj dhe me mjete të tjera të përshtatshme, në realizimin praktik të këtij parimi;

(b) të miratojë masat e duhura legjislative dhe të tjera, duke përfshirë edhe sanksione kur është e përshtatshme, që ndalojnë të gjitha diskriminimet ndaj gruas; ...

Neni 7. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas në jetën politike dhe publike të vendit dhe, në veçanti,

duhet të sigurojnë për gratë, kushte të barabarta me burrat, të drejtën e:

(a) Votimit në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike dhe të mund të zgjidhen në organet e zgjedhur publikisht;

(b) Të marrë pjesë në formulimin e politikave qeveritare dhe zbatimin e saj dhe për të mbajtur poste publike dhe të kryejë të gjitha funksionet

publike në të gjitha nivelet e qeverisjes;

(c) Të marrë pjesë në organizatat jo-qeveritare dhe shoqatat që merren me jetën publike dhe politike të vendit ...

RRETH OSBE/ODIHR-it

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së për të ndihmuar Shtetet pjesëmarrëse “për të siguruar respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të respektuar sundimin e ligjit, për të promovuar parimet e demokracisë dhe (...) për të ndërtuar, përforcuar dhe mbrojtur institucionet demokratike, si dhe për nxitjen e tolerancës në të gjithë shoqëritë”. (Dokumenti i Helsinkit 1992).

ODIHR-i, me seli në Varshavë, Poloni, u krijua si Zyra për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit 1990 dhe ka filluar veprimtarinë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat të zgjeruar për të përfshirë të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot ai punëson personel mbi 100 veta.

ODIHR është agjencia udhëheqëse në Evropë në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve. Ai bashkërendon dhe organizon dërgimin e disa misioneve të vëzhgimit me mijëra vëzhgues secilin vit për të vlerësuar nëse zgjedhjet në zonën e OSBE-së janë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Metodologjia e tij unike ofron një depërtim në thellësi në të gjitha elementet e një procesi zgjedhor. Nëpërmjet projekteve të asistencës, ODIHR-i ndihmon shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin zgjedhor.

Aktivitetet e Zyrës për demokratizim përfshijnë sferat tematike të mëposhtme: shtetin juridik, shoqërinë civile, si dhe lirinë e lëvizjes, barazinë gjinore dhe trafikimin e qenieve njerëzore. ODIHR-i zbaton më shumë se 100 programe të asistencës në shënjestër çdo vit, duke u munduar të lehtësojë dhe përmirësojë gjendjen në përputhje me zotimet e OSBE-së dhe ti zhvillojë strukturat demokratike.

ODIHR mbështet mbrojtjen e të drejtave të njeriut nëpërmjet projekteve të asistencës teknike dhe trajnimit për çështje të dimensionit njerëzor. Ai zhvillon hulumtime dhe përgatit raporte mbi tema të ndryshme të të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, Zyra organizon disa takime çdo vit për të shqyrtuar zbatimin e angazhimeve të OSBE-së të dimensionit njerëzor nga shtetet pjesëmarrëse. Në veprimtaritë e saj kundër-terrorizmit, ODIHR punon për ndërtimin e vetëdijes për çështjet e dimensionit njerëzor dhe kryen projekte që rrënjësisht t’ju drejtohet faktorëve për rrezikun prej terrorizmit.

ODIHR-it ofron këshilla shteteve pjesëmarrëse mbi politikat e tyre për Romët edhe Sinti. Ai promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjeteve midis komuniteteve romë dhe Sinti dhe inkurajon pjesëmarrjen e Romëve dhe Sinti në organet përfaqësuese të miratimit të politikave. Zyra gjithashtu vepron si një zyrë qendrore për këmbimin e informat-

ave mbi çështjet rome dhe Sinti midis aktorëve kombëtarë dhe ndërkom-bëtarë.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it janë kryer në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e OSBE-së dhe operacionet në terren, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më shumë informacion të vlefshme në faqen e ODIHR-it (<http://www.osce.org/odih>).

Ky manual ofron udhëzime mbi monitorimin e pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor. Ajo ka qenë zhvilluar si pjesë e përpjekjeve të OSBE/ODIHR-it për të përmirësuar barazinë midis grave dhe burrave duke theksuar qartë çështjet gjinore në të gjitha sferat e punës së tij.

Ky manual është hartuar si një mjet pune për ti ndihmuar MVZ të OSBE/

ODIHR-it në identifikimin e elementeve të ndryshme që mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e barabartë të grave. Ai përcakton hapat praktike që duhet të ndërmerren për integrimin e perspektivës gjinore në vëzhgimin e zgjedhjeve dhe duhet të shërbejë për të siguruar që konkluzionet e nxjerra në shkallën në të cilën një proces zgjedhor i plotëson zotimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike merr plotësisht parasysh si ndikon në procesi zgjedhor edhe mbi gratë edhe mbi burrat.

Përveç përdorimit nga Misionet Vëzhguese për Zgjedhjet të OSBE/ODIHR-it, manuali gjithashtu ka rëndësi të gjerë për përpjekjet e vëzhguesve të tjerë ndërkombëtar të zgjedhjeve dhe për punën e grupeve të vëzhguese vendor të zgjedhjeve.

